

KODI I SJELLJES I
BNP PARIBAS GROUP



BNP PARIBAS

Bankë
për një botë
në lëvizje

PARATHËNIE



“

Jean Lemierre
Kryetar i Bordit të Drejtorëve

Jean-Laurent Bonnafé
Kryeshef Ekzekutiv

Bordi i Drejtorëve dhe Menaxhmenti i Përgjithshëm i BNP Paribas ndajnë bindjen se suksesi i bankës varet drejtpërdrejtë nga sjellja e çdo punonjësi.

Së bashku, i jemi përkushtuar ndërtimit të së ardhmes së BNP Paribas mbi themelet e ekspertizës dhe integritetit profesional.

Kjo kërkon që të sigurohet angazhimi i të gjithë punonjësve të të gjithë Grupit, dhe të fitohet besimi e partnerëve, klientëve dhe aksionarëve tanë, si dhe të zyrtarëve publikë dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile në çdo vend ku vepron banka.

Që ta arrijmë këtë, duhet patjetër t'u përmbahemi ligjeve dhe rregulloreve. Në të njëjtën kohë, duhet të shkojmë më tej dhe të sigurohemi se çdo vendim udhëhiqet nga një ndjenjë e thellë e përgjegjësisë etike. Kjo fillon me aftësinë e të mësuarit nga praktikrat e papërshtatshme.

Bota në të cilën operon banka vazhdon të ndryshojë me ritëm të përshpejtuar. BNP Paribas mund t'i menaxhojë këto ndryshime duke i parashikuar, duke iu përshtatur dhe duke sjellë risi në sajë të një kulture korporative të ankoruar në vlera të forta që aplikohen pa kompromis.

Kjo frymë ka formuar Kodin tonë të Mirësjelljes, i cili përcakton rregullat që drejtojnë të gjitha veprimet tona, në përputhje me vlerat tona thelbësore. Shpreh atë që aspirojmë të jemi: një nga bankat më të respektuara evropiane me shtrirje globale dhe lider në financa të qëndrueshme.

Kodi i Mirësjelljes është një udhëzues për veprimet dhe vendimet tona. Nuk ka rregulla të veçanta që mund të aplikohen në çdo situatë. Përkundrazi, Kodi i Mirësjelljes, i ndihmuar nga gjykimi personal, duhet të jetë i ngulitur mjaftueshëm që të sigurohet respektimi i përhershëm i kësaj fryme.

Kemi besim se të gjithë punonjësit tanë zbatojnë plotësisht këto vlera dhe parime, të cilat mbështesin kontributin tonë për shoqërinë, unitetin tonë dhe suksesin tonë.

”

17 dhjetor 2021

PËRMBLEDHJE

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM	05
-------------------------	----

A - MISIONI DHE VLERAT	06
------------------------	----

◆ Misioni	07
◆ Vlerat	08

B - RREGULLAT E MIRËSJELLJES	10
------------------------------	----

1 Interesat e klientëve	12
◆ Të kuptuarit e nevojave të klientëve	
◆ Sigurimi i trajtimit të drejtë të klientëve	
◆ Mbrojtja e interesave të klientëve	
◆ Mbrojtja e konfidencialitetit të klientëve	
◆ Komunikimi transparent në shitje dhe marketing	
◆ Trajtimi i drejtë i ankesave të klientëve	
2 Siguria financiare	16
◆ Lufta kundër pastrimit të parave, ryshfetit, korrupsionit dhe financimit të terrorizmit	
◆ Pajtueshmëria me sanksionet dhe embargot	
3 Integriteti i tregut	18
◆ Nxitja e konkurrencës së lirë dhe të drejtë	
◆ Pajtueshmëria me rregullat e abuzimit të tregut	
◆ Menaxhimi i konflikteve të interesave	
4 Etika profesionale	20
◆ Nuk përdoret kurrë informacioni i brendshëm për transaksione personale	
◆ Shmangia e konflikteve të interesave në aktivitete të jashtme	
◆ Asnjëherë mos shkëmbeni informata të ndjeshme tregtare me konkurrentët dhe mos e koordinoni me konkurrentët politikën tregtare të grupit	
◆ Marrja e masave kundër ryshfetit dhe korrupsionit	
5 Respekti për kolegët	24
◆ Zbatimi i standardeve më të mira të sjelljes profesionale	
◆ Mospranimi i asnjë forme të diskriminimit	
◆ Garantimi i sigurisë në vendin e punës	
6 Mbrojtja e grupit	27
◆ Ndërtimi dhe mbrojtja e vlerës afatgjatë të BNP Paribas Group	
◆ Mbrojtja e informacionit të Grupit	
◆ Komunikimi i përgjegjshëm	
◆ Veprimi etik me palët nga jashtë	
◆ Marrja e rreziqeve në mënyrë të përgjegjshme, duke siguruar kontroll nga afër të rrezikut	
◆ Ruajtja e përgjegjësisë kur largohesh nga BNP Paribas Group	
7 Përfshirja me Shoqërinë	30
◆ Promovimi i respektit për të Drejtat e Njeriut	
◆ Mbrojtja e mjedisit dhe lufta kundër ndryshimeve klimatike	
◆ Veprimi me përgjegjësi në përfaqësimin publik	
◆ Kontribumi në një shoqëri më gjithëpërfshirëse	

C - KODI I MIRËSJELLJES NË PRAKTIKË	33
-------------------------------------	----

- ◆ Marrja e vendimeve
- ◆ Si përshtatet Kodi me ligjet vendore dhe ndërkombëtare?
- ◆ Shprehja dhe ngritja e shqetësimeve
- ◆ Përgjegjësitë shtesë për menaxherët

D - SHTOJCË: CKODI I SJELLJES: LUFTIMI I KORRUPSIONIT	38
---	----

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

“KODI I MIRËSJELLJES I BNP PARIBAS GROUP ËSHTË THELBI I ÇDO VEPRIMI. AI UDHËHEQ TË GJITHA VENDIMET NË TË GJITHA NIVELET E ORGANIZATËS. ANDAJ, TË GJITHA POLITIKAT DHE PROCEDURAT E BRENDSHME BREND GRUPIT DO TË RISHIKOHEN DHE DO TË BËHEN NË PËRPUTHJE ME KODIN NËSE KONSIDEROHET E NEVOJSHME.

KODI I MIRËSJELLJES PËRBËHET NGA TRI PJESË. PJESA E PARË, MBI MISIONIN DHE VLERAT, KA PËR QËLLIM TË DREJTOJË DHE FRYMËZOHË TË GJITHA SJELLJET. PJESA E DYTË MBULON RREGULLAT E MIRËSJELLJES QË DUHEN NDARË DHE TË ZBATOHEN. PJESA E TRETË, E QUAJTUR KODI I MIRËSJELLJES NË PRAKTIKË, JEP UDHËZIME TË DOBISHME SI TË ZBATOHEN RREGULLAT E MIRËSJELLJES..

MISIONI DHE VLERAT

Misioni

Pohon çka përfaqëson Grupi dhe cili është qëllimi i tij.

Vlerat

Qasja e BNP Paribas – drejton veprimet tona. Qasja e BNP Paribas ngrihet mbi katër Fuqitë dhe katër Forcat Shtytëse.

RREGULLAT E MIRËSJELLJES

Rregullat e sjelljes janë rregulla konkrete të cilat duhet t'i kuptojnë dhe t'i ndjekin të gjithë punonjësit e BNP Paribas Group. Pajtueshmëria me këto rregulla është thelbësore për aftësinë tonë të shpalosjes së Vlerave dhe standardeve tona etike dhe, parakusht veprimit sipas Përqasjes së BNP Paribas.

KODI I MIRËSJELLJES NË PRAKTIKË

Kjo pjesë jep detaje si zbatohet Kodi i Mirësjelljes. Qartazi artikulon çka pritët nga secili punonjës dhe pyetjet që secili duhet t'ia shtrojë vetes para se të marrë vendime. Gjithashtu, trajton çështjen e përshtatjes së Kodit me ligjet apo rregulloret lokale, si dhe merret me politikën tonë të sinjalizimit (whistleblowing). Çdo biznes do të jetë përgjegjës për përshtatjen dhe zbatimin kur është e përshtatshme, implikimin në praktike të Kodit të Sjelljes për aktivitetet e tyre përkatëse.

MISIONI DHE VLERAT

KONTRIBUTI SOCIAL I BNP PARIBAS GROUP FILLON ME PËRGJEGJËSINË E SAJ EKONOMIKE TË FINANCIMIT TË EKONOMISË NË MËNYRË ETIKE, DUKE NDIHMUAR KLIENTËT TANË QË TË REALIZOJNË PLANET DHE PROJEKTET E TYRE. PËR MË TEPËR, GRUPI ËSHTË I PËRFSHIRË NGUSHTË NË BASHKËSITË LOKALE KU VEPRON, DHE PRANON SE KA PËRGJEGJËSI SHITESË SOCIALE, QYTETARE DHE MJEDISORE.



Për t'u siguruar se ndikimi i punës së punonjësve të saj është pozitiv, BNP Paribas Group përkrah standardet më të larta të sjelljes dhe etikës në fushën e të drejtave të njeriut, punës, mjedisit dhe anti-korrupsionit. Andaj, Grupi pranon dhe angazhohet që të respektojë një numër parimesh dhe normash që e shquajnë përjashten e tij ndaj biznesit:

- ◆ 10 parimet e Global Compact dhe Qëllimet për Zhvillim të Qëndrueshëm e Organizatës së Kombeve të Bashkuara²
- ◆ Parimet udhëheqëse e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të drejta afariste dhe të njeriut (UNGP)³
- ◆ Udhëzimet ndërkombëtarisht të pranuar të OECD-së për ndërmarrjet shumëkombëshe⁴
- ◆ Standardet ndërkombëtarisht të pranuar të të drejtave të njeriut, siç përcaktohen në Kartën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut
- ◆ 8 Konventat themelore të punës të përcaktuara nga Organizata Ndërkombëtare e Punës⁵

2 - <https://www.unglobalcompact.org/what-is-gc/mission/principles>

3 - https://www.ohchr.org/Documents/Publications/GuidingPrinciplesBusinessHR_EN.pdf

4 - <http://www.oecd.org/daf/inv/mne/48004323.pdf>

5 - <https://www.ilo.org/global/standards/introduction-to-international-labour-standards/conventions-and-recommendations/lang--en/index.htm>

MISIONI

MISIONI I BNP PARIBAS ËSHTË QË TË SIGUROJË FINANÇIMIN PËR EKONOMINË DHE TË KËSHILLOJË KLIENTËT NË MËNYRË ETIKE, DUKE MBËSHTETUR PROJEKTET, INVESTIMET DHE MENAXHIMIN E KURSIMEVE TË TYRE⁶:

◆ Ne duam të kemi ndikim pozitiv në palët tona të interesit – klientët, partnerët tregtarë, punonjësit, aksionarët – dhe në shoqërinë. Ne duam të kontribuojmë në një të ardhme më të mirë.

◆ Ekipet tona shumë të përkushtuara do t'u ofrojnë klientëve tanë shërbim dhe zgjidhje të klasit të parë përmes modelit të integruar të Grupit.

◆ Kolegëve tanë do t'u ofrojmë vend pune frymëzues dhe stimulues.

◆ Duam të jemi mes lojtarëve më të besueshëm të industrisë sonë, duke i ngulitur më tej vlerat dhe etikën tonë në çdo gjë që bëjmë.

Në mjedisin e sotëm, nuk mjafton vetëm respektimi i ligjeve dhe rregullave.

Gjithashtu, duam të demonstrojmë se aktivitetet e BNP Paribas kanë ndikim pozitiv në të gjitha grupet tona të gjera të interesit, dhe se Grupi është edhe një kompani fitimprurëse dhe aktor i përgjegjshëm në ekonominë të cilave u shërben.

Modeli i integruar i BNP Paribas Group na lejon të ofrojmë shërbimin e klasit të parë që kërkojnë dhe meritojnë klientët. Mbajtja e një modeli të integruar nuk lidhet vetëm me diversifikimin e rrezeve. Ka të bëjë edhe me mënyrën si punonjësit u shërbejnë klientëve tanë. Modeli i integruar i Grupit na mundëson njohjen e detajuar të klientëve tanë, si dhe aftësinë e shfrytëzimit të burimeve dhe aftësive të gjera të Grupit për të ofruar zgjidhjet më të mira të mundshme.

Çdo ditë, modeli i integruar na lejon të fitojmë besimin e klientëve tanë anëmbanë globit.

Gjithashtu, e kemi për detyrë të jemi gjithmonë të vëmendshëm ndaj pritshmërive të punonjësve tanë, pasuria më e vlefshme e Grupit. Puna e tyre e fortë dhe idetë e tyre janë shtytësit e suksesit të BNP Paribas Group. Që të kenë sukses, punonjësit tanë duhet të punojnë në mjedis frymëzues dhe stimulues.

Kur sjelljet e përditshme nguliten në Vlerat tona dhe secili vepron me sjellje pa të meta, ndërtohet besimi mes kolegëve dhe i klientëve. Ky besim është çka e veçon BNP Paribas Group në radhët e industrisë sonë.

Misioni i Grupit përfshin një spektër të gjerë të palëve të interesuara. Të gjithë janë përgjegjës që të sigurohemi se vlerat dhe rregullat tona janë më shumë se fjalë të thjeshta dhe që t'i vëmë në jetë, si në nivel personal ashtu edhe kolektiv brenda BNP Paribas Group.

BNP Paribas Group do të udhëhiqet në realizimin e misionit të vet nga Vlerat që mbështesin të gjitha veprimet dhe vendimet në të gjithë organizatën.

6 – Qëllimi i Grupit BNP Paribas është një tekst i bazuar në dokumentet e Misionit dhe Vizionit, Kodit të Sjelljes dhe Manifestit të Angazhimit, të disponueshme këtu: <https://group.bnpparibas/en/group/our-company-purpose>

VLERAT

VLERAT TONA – PËRQASJA E BNP PARIBAS – PËRFAQËSOJNË PIKËPAMJEN KOLEKTIVE TË MIJËRA PUNONJËSVE TË BNP PARIBAS GROUP. VLERAT TONA THEMELORE U ZHVILLUAN NËPËRMJET NJË PROCESI BASHKËPUNUES, NË TË CILIN U FTUAN TË KONTRIBUOJNË TË GJITHË PUNONJËSIT E BNP PARIBAS GROUP.

Të gjithë në Grup duhet të udhëhiqen nga këto vlera në aktivitetet e tyre të përditshme. Shpalosja e Vlerave u mundëson punonjësve aktualë dhe të ardhshëm të kuptojnë më mirë çka pritet prej tyre dhe çka e bën unik BNP Paribas Group.

Mbajtja e këtyre vlerave është thelbësore për të aplikuar strategjinë e transformimit dhe rritjes e Grupit ndërsa duke ruajtur besimin që klientët, partnerët tregtarë, punonjësit, aksionarët dhe komuniteti më i gjerë vendosin në Bankë.

FUQITË TONA

Fuqitë janë themelet e BNP Paribas Group. Ato do të lejojnë ruajtjen e modelit të shërbimeve bankare të integruara dhe pozitive kryesuese në të ardhmen.

STABILITETI	PËRGJEGJËSIA	EKSPERTIZA	VEND I MIRË PUNE
Rritemi mbi bazat e menaxhimit tonë të qëndrueshëm dhe me orientim afatgjatë, sipas modelin tonë të biznesit të integruar e të larmishëm dhe gjurmës sonë ndërkombëtare	Përdorim kulturën tonë të përgjegjësisë dhe integritetit që t'u shërbejmë gjithnjë e më mirë interesave të klientëve tanë	Ndërtojmë mbi njohuritë e pranuar dhe në zgjerim të ekipeve tona	Nxisim një vend pune stimulues ku njerëzit trajtohen në mënyrë të drejtë dhe me respekt

FORCAT TONA SHTYTËSE

Forcat Shtytëse janë fushat në të cilat të gjithë punonjësit duhet gjithmonë të punojnë dhe t'i zhvillojnë që të kenë sukses në sfidat e tyre dhe të ndërtohet e ardhmja e BNP Paribas Group.

AGILITY	KULTURA E PAJTUESHMËRISË	KËNAQËSIA E KLIENTIT	SINQERITETI
Duam të sillemi më thjesht, t'i përqafojmë risitë e dobishme dhe transformimin digjital	Besojmë në promovimin e rregullave të qarta që nxisin kulturë të fortë të pajtueshmërisë dhe etikës	Besojmë se suksesi ynë qëndron në të qenit zgjedhja e preferuar e klientëve tanë dhe përdoruesve të shërbimeve tona. Përpiqemi t'i dëgjojmë me kujdes dhe të punojnë ngushtë me ta	Promovojmë qëndrim mendjehapur ndaj grupeve tona të interesit. Synojmë që të gjithë në Grup të ndihen të përfshirë, ta thonë fjalën e tyre dhe të fuqizohen

ÇKA LYPET QË T'IA DALIM

**JETËSIMI I VLERAVE TONA DHE REALIZIMI I MISIONIT TONË KËRKOJNË
PREJ NESH TË JEMI TË PËRGATITUR PËR ZGJEDHJE DHE VENDIME
TË GUXIMSHME..**

Grupi është i përkushtuar në përmirësimin e vazhdueshëm:

SI KRYHET BIZNESI

- ◆ Adresoni nevojat e klientëve në mënyrë transparente dhe të ndershme, të hapur dhe të përgjegjshme, promovoni konkurrencë të hapur dhe të ndershme me standardet më të larta të pajtueshmërisë dhe etikës
- ◆ Kolektivisht ndërtojmë mbi ekspertizën tonë që të arrijmë përsosmërinë në bizneset që kemi zgjedhur për veprim
- ◆ Konsiderojmë pasojat e veprimeve tona në shoqërinë e gjerë

SI KRYHET PUNA

- ◆ Nxism risi digjitale dhe të dobishme
- ◆ Thjeshtojmë më tej mënyrën e punës që të rrisim zhdërvjelltësinë
- ◆ Lejojmë njerëzit të eksperimentojnë përmes qasjes testo dhe mëso
- ◆ U besojmë njerëzve dhe i fuqizojmë të përqafojnë mundësitë e biznesit dhe zhvillimin e klientit brenda një kuadri të qartë
- ◆ Marrim vendime në të gjitha nivelet e organizatës dhe jemi përgjegjës për veprimet tona

SI KUJDESEMI PËR NJERËZIT

- ◆ Promovojnë diversitetin në mënyrë aktive
- ◆ Inkurajojmë lëvizshmërinë për të ofruar përvoja të shumëllojshme
- ◆ Zhvillojmë talentet dhe vazhdojmë të investojmë në pasurinë kyç të Grupit: njerëzit e tij

RREGULLAT E MIRËSJELLJES

QË TË JETËSOJMË VLERAT TONA – PËRQASJA E BNP PARIBAS – DUHET T'I RESPEKTOJMË RREGULLAT. NË KËTË DOKUMENT DO TË GJENI NJË ARTIKULIM TË QARTË TË SJELLJEVE TË PRANUESHME DHE TË PAPRANUESHME. PAJTUESHMËRIA ME KËTO RREGULLA ËSHTË THELBËSORE PËR AFTËSINË TONË TË SHPALOSJES SË VLERAVE DHE STANDARDEVE TONA ETIKE DHE, PARAKUSHT I VEPRIMIT SIPAS PËRQASJES SË BNP PARIBAS.

RREGULLAT RENDITEN SIPAS SHTATË TEMAVE TË MËPOSHTME.



TEMAT E MIRËSJELLJES	VLERAT Fuqitë dhe Forcat shtytëse	RREGULLAT E MIRËSJELLJES
1 INTERESAT E KLIENTËVE		◆ Kuptimi i nevojave të klientëve ◆ Sigurimi i trajtimit të drejtë të klientëve ◆ Mbrojtja e interesave të klientëve ◆ Mbrojtja e konfidencialitetit të klientëve ◆ Komunikim transparent në shitje dhe marketing ◆ Ballafaqim të drejtë me ankesat e klientëve
2 SIGURIA FINANCIARE	EKSPERTIZA – KËNAQËSIA E KLIENTIT – PËRGJEGJËSIA – KULTURA E PAJTUESHMËRISË	◆ Lufta kundër pastrimit të parave, ryshfetit, korrupsionit dhe financimit të terrorizmit ◆ Pajtueshmëria me sanksionet dhe embargot
3 INTEGRITETI I TREGUT		◆ Promovimi i konkurrencës së lirë dhe të ndershme ◆ Pajtueshmëria me rregullat e abuzimit në treg ◆ Menaxhimi i konflikteve të interesit
4 ETIKA PROFESIONALE		◆ Nuk përdoret kurrë informacioni i brendshëm për transaksione personale ◆ Asnjëherë mos shkëmbeni informata të ndjeshme tregtare me konkurrentët dhe mos e koordinoni me konkurrentët politikën tregtare të Grupit ◆ Shmangia e konflikteve të interesave në aktivitete të jashtme ◆ Marrja e masave kundër ryshfetit dhe korrupsionit
5 RESPECT PËR KOLEGËT	VEND I MIRË PUNE – SINQERITETI	◆ Aplikimi i standardeve më të mira në sjelljen profesionale ◆ Mospranimi i asnjë forme të diskriminimit ◆ Garantimi i sigurisë në vendin e punës
6 MBROJTJA E GRUPIT	STABILITETI – ZHDËRVJELLTËSIA	◆ Ndërtimi dhe mbrojtja e vlerës afatgjatë të BNP Paribas Group ◆ Mbrojtja e informacionit të Grupit ◆ Komunikimi i përgjegjshëm ◆ Veprimi etik me palët nga jashtë ◆ Marrja e rreziqeve në mënyrë të përgjegjshme, duke siguruar kontroll nga afër të rrezikut ◆ Ruajtja e përgjegjësisë kur largohesh nga BNP Paribas Group
7 PËRFSHIRJA ME SHOQËRINË	PËRGJEGJËSIA – KULTURA E PAJTUESHMËRISË	◆ Promovimi i respektit për të Drejtat e Njeriut ◆ Mbrojtja e mjedisit dhe lufta kundër ndryshimeve klimatike ◆ Veprimi me përgjegjësi në përfaqësimin publik ◆ Kontribuimi në një shoqëri më gjithëpërfshirëse

1

INTERESAT E KLIENTËVE

SUKSESI YNË QËNDRON NË TË QENIT ZGJEDHJA E PREFERUAR E KLIENTËVE TANË. PËR TË FITUAR BESIMIN E KLIENTËVE TANË, TË GJITHË PUNONJËSIT DUHET GJITHMONË TË VEPROJNË NË NJË MËNYRË QË I MBRON INTERESAT E KLIENTËVE, DUKE QENË NË PAJTUESHMËRI ME TË GJITHA LIGJET RELEVANTE.

Për ta arritur këtë, BNP Paribas Group investon për të kuptuar nevojat e klientëve të vet. Komunikimi me klientët është i hapur dhe i ndershëm dhe shërbimet e ofruara ndaj tyre duhet të jetë zgjedhja më e përshtatshme për të përmbushur nevojat dhe qëllimet e tyre. Të gjithë punonjësit gjithmonë përpiqen të sigurojnë që interesat afatgjata të klientëve merren parasysh. Në rast se një klient është i pakënaqur, duhet ndërmarrë veprim i shpejtë për t'i rregulluar punët.

TË KUPTUARIT E NEVOJAVE TË KLIENTËVE

E kemi detyrë që t'i kuptojmë nevojat e klientëve dhe jemi përgjegjës që:

- ◆ Të kërkojnë gjithmonë të kuptojmë nevojat, pritjet dhe interesat e klientëve në mënyrë që t'u sigurojmë produktet dhe shërbimet e duhura

SIGURIMI I TRAJTIMIT TË DREJTË TË KLIENTËVE

Është thelbësore që të sigurohet trajtim i drejtë i klientëve dhe pritjet janë që:

- ◆ Të veprojmë në mënyrë të drejtë, të ndershme dhe transparente në të gjitha veprimet profesionale, që të fitojmë besimin e klientëve
- ◆ Shmangim ofrimin e trajtimit preferencial të padrejtë për cilindo klient
- ◆ Punojmë me klientët që gjenden në vështirësi financiare për të gjetur një zgjidhje reciprokisht të dobishme për gjendjen e tyre

MBROJTJA E INTERESAVE TË KLIENTËVE

Kemi angazhim të fortë për të mbrojtur interesat më të mira të klientëve, çka kërkon prej nesh:

- ◆ T'i njohim dhe të jemi në pajtueshmëri me rregullat e mbrojtjes së të drejtave të klientëve në tregjet ku operon Grupi
- ◆ Të dizajnojmë produkte duke pasur parasysh interesat e klientëve
- ◆ Të sigurohemi se produktet e shitura shpjegohen lehtë
- ◆ Të sigurohemi se produktet mund të kuptohen nga klientët
- ◆ Të aplikojmë çmime të drejta dhe transparente në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi
- ◆ Sigurohuni që aktivitetet të jenë në pajtueshmëri me ligjet dhe rregulloret në fuqi, duke përfshirë ligjin për konkurrencën dhe rregullat tatimore



MBROJTJA E KONFIDENCIALITETIT TË KLIENTËVE

Është e rëndësishme që të mbrohet konfidencialiteti i klientëve, që do të thotë:

- ◆ Të mos veprojmë kurrë në emër të një klienti pa autorizim (p.sh. mandat apo udhëzim të klientit)
- ◆ I trajtojmë të gjitha marrëdhëniet me klientët si rreptësisht konfidenciale
- ◆ Ruajmë konfidencialitetin e informacionit të klientit në çdo kohë, përveç nëse zbulimi dhe/ose përdorimi i informacionit është i lejuar me ligjin në fuqi dhe/ose me pëlqimin e shprehur të klientit
- ◆ Ndajmë informacionin e klientit brenda BNP Paribas Group me ata kolegë të cilët me të vërtetë duhet ta shohin për t'u shërbyer interesave më të mira të klientëve në përputhje me ligjin në fuqi dhe rregullat e brendshme
- ◆ Mbledhim vetëm të dhëna të nevojshme për një qëllim të veçantë profesional
- ◆ >Pajtueshmëri me sistemin e barrierave të informacionit të Grupit



Një klient erdhi për të më informuar se ai / ajo do të divorcohet nga partneri i tij / saj dhe për këtë arsye planifikon të hapë një llogari në emrin e tij / saj. Ai / ajo më kërkoi që ta informoja për burimet personale që partneri i tij / saj zotëron në të njëjtën bankë, pasi ai / ajo ka disa vështirësi financiare.

A duhet ta ndihmoj këtë klient?

Absolutisht jo. Ju i nënshtroheni sekretit bankar. Ju nuk duhet ta pranoni këtë kërkesë.



Një pronar i biznesit po konsideron blerjen e pasurive të patundshme komerciale nga pasuria e tij private. Ai më pyeti si mund ta strukturojë sa më mirë blerjen.

A mund ta ndaj informacionin e klientit me kolegët e mi të menaxhimit të pasurisë para takimit të klientit?

Po, nëse është në pajtueshmëri me sistemin e barrierave të informacionit të Grupit. Brenda BNP Paribas Group, mund të ndani informacionin nëse është në interesin më të mirë të klientit dhe i lejon Grupit të japë vlerën e plotë të modelit të vet të integruar.





KOMUNIKIMI TRANSPARENT NË SHITJE DHE MARKETING

Të gjitha komunikimet komerciale drejtuar klientëve duhet të jenë transparente në lidhje me shërbimet dhe produktet e ofruara dhe prej nesh pritët që:

- ◆ Të synojmë të sigurohemi që të gjitha komunikimet me klientët janë të drejta, të ndershme, transparente, të kuptueshme dhe jo çorientuese
- ◆ Të kryejmë me integritet shitjen dhe marketingun e produkteve dhe shërbimeve të Grupit
- ◆ Të ofrojmë të gjitha informacionet e kërkuara në mënyrë që klientët të mund të kuptojnë:
 - Çka po blejnë, duke përfshirë performancën e pritshme, çmimet dhe karakteristikat e rrezikut
 - Çka po paguajnë, duke përfshirë koston e produkteve, shërbimeve dhe këshillave të zgjedhura
- ◆ T'u përgjigjemi pyetjeve të klientëve sa më mirë që mundemi dhe në kohën e duhur



ANjë klient dëshiron të blejë një produkt që mendoj se i duhet, por produkti nuk konsiderohet i përshtatshëm nga kuadri rrezikut i BNP Paribas Group. Pavarësisht diskutimeve të shumta, ai nuk i merr parasysh alternativat dhe po kërcënon se do ta çojë biznesin e tij diku tjetër.

Çfarë duhet te bej?

Është përgjegjësia juaj të shpenzoni kohë me klientin për ta ndihmuar të kuptojë karakteristikat e produktit dhe rreziqet e lidhura, pasi ne duhet t'u ofrojmë të gjithë informacionin përkatës klientëve tanë. Duhet t'i shpjegoni se besoni se produkti mund ose nuk mund t'i plotësojë objektivat dhe nevojat e klientit. Nëse besoni se produkti nuk është në interesin e klientit, atëherë nuk duhet të angazhoheni në këtë transaksion. Mund të propozoni një ose më shumë alternativa të përshtatshme. Mund të kërkon ndihmë nga menaxheri juaj nëse është e nevojshme. Interesat afatgjata të klientëve dhe reputacioni i grupit mbizotërojnë ndaj fitimeve afatshkurtra. Bëni këtë bisedë të singertë me klientin dhe largohuni nga transaksioni nëse duhet.





Një klient korporatë dëshiron të kryejë një transaksion që të sigurohet nga një rrezik i veçantë. Për fat të keq, ekspozimi themelor nuk mund të sigurohet në mënyrë të përkryer në treg. Zgjidhja e vetme është të përdoret një indeks i autorizuar që ka dëshmuar në të kaluarën korrelacionin e lartë me evoluimin e ekspozimit themelor. Materiali ynë i marketingut tregon se kjo ka qenë një mbrojtje shumë e efektshme gjatë 5 viteve të fundit.

Si duhet t'ia komunikoj këtë klientit?

Korrelacioni i shkuar nuk garanton se sigurimi do të lidhet me ekspozimin themelor në të ardhmen; duhet t'ia tregoni këtë rrezik klientit, edhe nëse konsiderohet i ulët. Nëse është e nevojshme, mund të përfshini simulime që tregojnë ndikimin e mundshëm.



TRAJTIMI I DREJTË I ANKESAVE TË KLIENTËVE

E kemi detyrë trajtimin e drejtë të ankesave të klientëve, që do të thotë ne:

- ◆ Trajtojmë ankesat e klientëve në mënyrë të drejtë, transparente dhe në kohën e duhur
- ◆ Rregullojmë punët sa më shpejt që të jetë e mundur, nëse janë identifikuar gabimet

2

SIGURIA FINANCIARE

BNP PARIBAS GROUP ËSHTË I PËRKUSHTUAR NË SHËRBIM TË KLIENTËVE TË VET. NË TË NJËJTËN KOHË, GRUPI GJITHMONË DUHET TË JETË I VETËDIJSHËM PËR NDIKIMIN QË VEPRIMET E VETA MUND TË KENË NË SHOQËRINË E GJERË. BNP PARIBAS GROUP ËSHTË E ANGAZHUAR PËR PAJTUESHMËRI ME TË GJITHA LIGJET NË FUQI PËR PARANDALIMIN E VEPRIMTARIVE KRIMINALE DHE TERRORISTE, DHE NË MBËSHTETJE TË VEPRIMIT NDËRKOMBËTAR QË KRYHET PËRMES INDUSTRISË FINANCIARE.

Për shkak se këto ligje mund të jenë komplekse, dhe zbatohen në mënyrë të ndryshme në biznese dhe rajone të ndryshme, Grupi është i përkushtuar për nxitjen e rregullave të qarta që nxisin një kulturë të fortë të pajtueshmërisë dhe etikës.

LUFTA KUNDËR PASTRIMIT TË PARAVE, RYSHFETIT, KORRUPSIONIT DHE FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

Është përgjegjësi e çdo punonjësi që të mbështesë grupin në luftën kundër krimit ekonomik, duke përfshirë mashtrimin, pastrimin e parave, ryshfetin, korrupsionin dhe financimin e terrorizmit. Prandaj, prej të gjithëve kërkohet:

- ◆ Të jemi vigjilentë dhe të kontribuojmë në luftën kundër të gjitha formave të krimit ekonomik, duke përfshirë mashtrimin, pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit, pavarësisht nga rrethanat apo aktorët e përfshirë
- ◆ Të sigurohemi për kryerjen e kujdesit të duhur dhe kontrolleve të njohjes së klientëve si ata përdorin produktet dhe shërbimet e Grupit
- ◆ Të jemi vigjilentë që transaksionet e klientëve të mos jenë të lidhura me ryshfet apo korrupsion. Të raportojmë çdo veprim të dyshimtë tek menaxhmenti i lartë ose Pajtueshmëria lokale



Këtë mëngjes, një nga klientët e mi më kërkoi lëshimin e një letër garancie për eksportin e municioneve në një vend nën sanksione (ndalimi i armëve).

Çfarë veprimi duhet të ndërmar?

Duhet ta refuzojë transaksionin dhe të njoftoni pikën tuaj hyrëse të Pajtuëshmërisë.



Kam vënë re se një nëpunës civil, i afërt me një ministër që vepron në një vend ku Grupi është aktiv, sapo pranoj një shumë të madhe parash në llogarinë e tij. Ai më dha një shpjegim për këtë transferë të madh, por transaksioni ende më duket i dyshimtë.

Çfarë duhet të bëj?

Duhet t'ia referoni këtë transaksion pikës suaj hyrëse të Pajtuëshmërisë në mënyrë që të sigurohemi se dëshmitë e dhëna janë mjaft bindëse. Nëse dëshmitë nuk janë mjaft bindëse, duhet të plotësohet Raporti i Transaksionit të Dyshimtë dhe të dërgohet tek autoriteti përkatës.



PAJTUESHMËRIA ME SANKSIONET DHE EMBARGOT

Grupi është e angazhuar për pajtuëshmëri me sanksionet dhe embargot e zbatueshme, që do të thotë një detyrim që:

- ◆ Të kuptojmë sanksionet ekonomike dhe embargot e aplikueshme në tregjet ku operon ose ka kontakte Grupi
- ◆ T'u përmbahemi politikave të Grupit dhe ligjeve lokale në lidhje me sanksionet dhe embargot në vendin në të cilin vepron Grupi
- ◆ Të raportojmë tek Siguria Financiare e Grupit çdo përpjekje për të anashkaluar sanksionet



Një nga klientët e mi inicioi një transfer në dollarë amerikanë për një përfitues që banon në një vend nën embargo, i cili u refuzua. Disa ditë më vonë, ai u përpoq të bëjë të njëjtën transfer me të njëjtën sasi dhe për të njëjtin përfitues, këtë herë me një adresë tjetër, në një vend që nuk u nënshtrohet sanksioneve financiare:

a pritet që unë bëj diçka në këtë rast?

Po, patjetër. Menjëherë duhet të dërgohet një raport anashkalimi tek Siguria Financiare e Grupit, dhe duhet të kryhet një kontroll i aktivitetit të shkuar të llogarisë për t'u siguruar që asnjë transaksion i ngjashëm nuk ka ndodhur në të kaluarën.

3

INTEGRITETI I TREGUT

TREGJET E DREJTA DHE EFEKTIVE JANË THELBËSORE PËR NJË EKONOMI EFIKASE DHE NË RITJE. BNP PARIBAS GROUP ËSHTË I PËRKUSHTUAR PËR RUAJTJEN DHE MBROJTJEN E INTEGRITETIT TË TREGJEVE. SJELLJA ANTI-KONKURRUESE REFUZOHET DHE GRUPI ËSHTË I PËRKUSHTUAR PËR NDËRTIMIN E NJË KULTURE TË PËRGJEGJËSISË DHE INTEGRITETIT PËR T’I SHËRBYER MË MIRË INTERESAVE TË KLIENTËVE TANË.

PROMOVIMI I KONKURRENCËS SË LIRË DHE TË DREJTË

Promovimi i konkurrencës së lirë dhe të ndershme është përkushtim i Grupit, pra ne:

- ◆ Pajtueshmëria me ligjet e konkurrencës në të gjitha juridiksionet në të cilat operon Grupi
- ◆ Nuk kërkojnë kurrë avantazh konkurrues nëpërmjet praktikave joetike ose të paligjshme
- ◆ Gjithmonë bashkëpunojmë me autoritetet e konkurrencës
- ◆ Gjithëmonë kujdesemi që të veprojmë në mënyrë të drejtë dhe me integritet në marrëdhëniet tregtare me klientët, furnitorët dhe / ose shpërndarësit dhe, në rast dyshimi kërkojmë këshilla nga menaxheri i përshtatshëm ligjor ose i pajtueshmërisë

PAJTUESHMËRIA ME RREGULLAT E ABUZIMIT TË TREGUT

Është përgjegjësi e çdo punonjësi:

- ◆ Respektojë plotësisht rregullat e abuzimit të tregut duke përfshirë rregullat e marrëdhënieve të brendshme dhe gjithmonë të bashkëpunojë me rregullatorët e tregut
- ◆ Të jetë proaktiv në identifikimin dhe raportimin e abuzimit të mundshëm të tregut dhe të veprojë për të minimizuar rrezikun e dëmit ndaj klientit dhe tregut
- ◆ Të mbrojë informacionin dhe të dhënat konfidenciale të tregut dhe klientit dhe të mos komunikojë asnjë informacion tregu të rrejshëm ose mashtrues
- ◆ Të jetë në pajtim me barrierat e informacionit (të njohura edhe si politika dhe procedura të “Murit kinez”)

- ◆ Të mos keqpërdorë kurrë informacionin e brendshëm
- ◆ Të mos veprojnë kurrë me qëllim të lëvizjes së një çmimi të tregut në një nivel që nuk reflekton kërkesën dhe ofertën e tregut (duke përfshirë treguesit dhe standardet e tregut)
- ◆ Të mos marrë pjesë kurrë në operacione që synojnë ndryshimin fiktiv të vlerës së tregut të aseteve ose detyrimeve në menyrë që të gjenerojë të ardhura ose profit, ose t'i shmanget humbjes



Një klient kërkon informacion për natyrën e urdhërave të blerjes/shitjes nga një klient tjetër i madh.

Çfarë duhet të them?

Yë është rreptësisht e ndaluar të zbulosh çfarëdo informacioni në lidhje me qëllimet e cilitdo prej klientëve ose homologëve tanë.



MENAXHIMI I KONFLIKTEVE TË INTERESAVE

BNP Paribas Group është një institucion global bankar që u shërbyen klientëve në shumë vende nëpërmjet disa linjave të biznesit. Për të menaxhuar çfarëdo konflikt të interesit që mund të lindë dhe përfshin BNP Paribas Group, është thelbësore që

- ◆ Të jemi proaktivë në lidhje me identifikimin, menaxhimin dhe zbulimin e çdo situatë ku BNP Paribas Group mund të ketë konflikt të interesit
- ◆ Nuk pranojmë kurrë një mandat as nuk përkushtohemi për një transaksion në emër të BNP Paribas Group pa kontrolluar nëse Grupi ka konflikt



Gjatë një takimi dëgjova disa informata jo-publike të cilat mund të ndikojnë negativisht në disa aksione që mbahen nga një miku im. Do të më vinte shumë keq sikur miku im të humbi para, dhe nuk kam asnjë interes personal financiar në këtë çështje.

A mund të ndaj këtë informacion pa rënë në sy?

Jo. Nuk duhet ta ndani informacionin me mikun tuaj. Nëse keni informata materiale jo-publike në lidhje me letrat me vlerë, informimi i një individi mbetet formë e tregtimit të brendshëm dhe mund të jetë shkelje e Ligjit.



Një klient më ka kërkuar të marr pjesë në financimin e blerjes së një kompanie të synuar. Megjithatë, një nga kolegët e mi në divizionin CIB po këshillon një konkurrent për të njëjtin transaksion.

A mund të vazhdoj me financimin?

Duhet t'ia referosh rastin Komitetit të Konfliktëve të Interesave të BNP Paribas Group. Duhet të sigurohesh që banka nuk ka konflikt para se të procedosh me çdo transaksion financiar dhe para se t'ia zbulosh informacionin klientit..



4

ETIKA PROFESIONALE

INTEGRITETI DHE ETIKA E SECILIT PUNONJËS SI INDIVID JANË BLOQET MË THEMELORE TË NDËRTIMIT TË KODIT TË MIRËSJELLJES SË BNP PARIBAS GROUP. RREGULLAT NË KËTË PJESË KANË SI QËLLIM SIGURIMIN E RUAJTJES SË NJË STANDARDI TË QËNDRUESHËM E TË LARTË TË INTEGRITETIT INDIVIDUAL DHE ETIKËS PROFESIONALE.

NUK PËRDORET KURRË INFORMACIONI I BRENDSHËM PËR TRANSAKSIONE PERSONALE

Të gjithë punonjësit duhet të jenë të përkushtuar për rregullat e mëposhtme:

për llogari personale dhe respektoni kufizimet në aktivitetet tregtare personale

◆ Nuk procedojmë kurrë letra me vlerë dhe transaksione financiare personale teksa zotërojmë informata relevante konfidenciale të marra në aktivitete profesionale

Përveç kësaj, punonjësit e ekspozuar ndaj IMJP (Informacionit Material Jo Publik) janë identifikuar si punonjës “të ndjeshëm” dhe duhet të angazhohen që:

◆ Mos u tregoni kurrë informacionet konfidenciale anëtarëve të familjes dhe rrethit të ngushtë

◆ Të sigurohen se i kuptojnë kufizimet që zbatohen ndaj tyre në lidhje me transaksionet personale

◆ Qëndroni në pajtim me politikat e brendshme të Grupit për letrat me vlerë dhe transaksionet financiare personale

◆ Të zbulojnë të gjitha transaksionet e tyre përkatëse personale në instrumente financiare

SHMANGIA E KONFLIKTEVE TË INTERESAVE NË AKTIVITETE TË JASHTME

Shtirirja e etikës profesionale gjithashtu përfshin aktivitetet e kryera jashtë BNP Paribas Group; si pasojë, çdo punonjës duhet të ketë kujdes që:

◆ Gjithmonë të kërkojë para-miratim për çdo mandat korporate jashtë BNP Paribas Group dhe, për të punësuarit e rinjë, gjithmonë të zbulojë mandatet ekzistuese të korporatave

◆ Të mos përfshijnë kurrë Grupin në aktivitete personale pa miratimin paraprak formal

◆ Gjithmonë të zbulojë çdo aktivitet biznesi jashtë BNP Paribas Group⁵ ku reputacioni i bankës mund të jetë në rrezik ose kur mund të lindin konflikte interesash

◆ Të jetë në pajtim me politikën e brendshme të Grupit në lidhje me aktivitete të jashtme

⁵ – Excluding trade union activities as defined in the French ‘Code du travail’.



Prej disa muajsh, jam i ngarkuar me marrëdhëniet e Bankës me disa nga furnizuesit e saj. Pas një thirrje për tender, kam zgjedhur 'Caterers & Co' që të kujdeset për furnizimin të një eventit për klientët. Tani më duhet të zgjedh një furnizues ushqimesh për martesën e fëmijës tim.

Çfarë duhet te bej?

Duhet bërë dallim i qartë mes interesave private dhe interesave profesionale, në mënyrë që të shmangen situatat që mund të shkaktojnë konflikt interesash. Marrëdhënia juaj me 'Caterers & Co' është iniciuar në kontekstin profesional; andaj duhet të përmbaheni nga përdorimi i këtij furnizuesi ushqimesh në një kontekst privat.



Dua të nis një biznes online, dhe të jem menaxher i kompanisë, përveç punës sime në BNP Paribas Group.

A më lejohet kjo gjë?

Nuk mund të jeni menaxher ose drejtor i biznesit tuaj, pa miratimin e shprehur nga BNP Paribas Group. Duhet formalisht t'i kërkonit leje BNP Paribas Group dhe të shpjegoni në detaje natyrën e mandatit që do të keni në kompani. Ky miratim paraprak do t'i lejojë bankës të vlerësojë nëse ekziston një konflikt interesi (në varësi të sektorit gjeografik, aktivitetit juaj në bankë, natyrës së biznesit, etj.) Pasi të merret autorizimi, zyra juaj do të renditet në databazë, si çdo zyrë tjetër private ose aktivitet i jashtëm që keni deklaruar. Në rast të një ndryshimi në zyrën tuaj ose pozite, duhet të informoni BNP Paribas në mënyrë që rreziku i konfliktit të interesit të mund të rivlerësohet.



Duke ditur se punoj në BNP Paribas Group, blerësi i makinës sime më ka kërkuar ta ndihmoj për të financuar blerjen e tij.

Çfarë duhet te bej?

Nuk duhet ta vësh veten në një situatë që përfshin një konflikt interesi. Prandaj, nuk duhet t'i jepni financim blerësit. Përkundrazi, duhet ta udhëzoni blerësin në degën ku ai jeton. Nëse ju punoni në këtë degë, duhet të kontaktoni menaxherin tuaj.



Partneri im drejton një firmë trajnimit dhe ka paraqitur një propozim për BNP Paribas Group për të drejtuar një nga programet tona të trajnimit.

A lejohet kjo?

Partneri juaj mund të paraqesë një propozim për BNP Paribas Group. Për të shmangur ndonjë konflikt të mundshëm të interesit, duhet ta zbuloni këtë marrëdhënie me menaxherin tuaj dhe ekipin e Prokurimit. Propozimi i partnerit tuaj do të merret parasysh në proceset tona standarde të prokurimit dhe ju duhet të përmbaheni nga çdo pjesëmarrje në këtë proces.



Një nga klientët e mi propozon të më japë para pasi jam duke kaluar një periudhë të vështirë në jetën time personale. Jam i tunduar sepse mes nesh ka një marrëdhënie besimi. Për më tepër, kam për t'ia kthyer.

A duhet të pranoj propozimin e klientit tim?

Absolutisht jo. Kjo do të çojë në një situatë të konfliktit të interesit. Duhet ta refuzoni ofertën dhe të gjeni një zgjidhje tjetër.





**ASNJËHERË MOS SHKËMBENI
INFORMATATË NDJESHME
TREGTARE ME KONKURRENTËT
DHE MOS E KOORDINONI
ME KONKURRENTËT POLITIKËN
TREGTARE TË GRUPIT**

Këto rregulla zbatohen pavarësisht nga konteksti (shoqatë profesionale, ngjarje sociale, projekt ndërbankar etj.) dhe mjetet (me gojë, me shkrim).



Unë përfaqësoj Grupin BNP Paribas në një shoqatë profesionale. Është planifikuar një studim tregu (benchmarking). Më kërkohet të paraqes informacion në lidhje me entitetin tim.

A mund të ndaj informata të ndjeshme tregtare?

Jo, nëse nuk është shpërndarja e informacionit dypalëshe mes jush dhe shoqatës, që shoqata siguron konfidencialitetin e këtij informacioni dhe se informacioni u përcillet të gjithë anëtarëve në një format të agreguar dhe anonim.





MARRJA E MASAVE KUNDËR RYSHFETIT DHE KORRUPSIONIT

Korrupsioni është i papranueshëm për BNP Paribas Group, pavarësisht nga forma dhe rrethanat e tij. Grupi dhe të gjithë punonjësit kanë zero tolerancë ndaj ryshfetit dhe korrupsionit, që duhet të luftohen në mënyrë aktive. Prandaj, e kemi detyrë:

- ◆ Të mos kërkojmë ose ofrojmë direkt ose indirekt komisione të paligjshme
- ◆ Të mos premtojmë, japin ose pranojmë kurrë çfarëdo përfitimi të pahijshëm biznesi që mund të ketë një ndikim në sjelljen e kërkuar të përfituesit

Si rezultat i kësaj, çdo punonjës pritet të jetë në pajtim me politikën e brendshme të Grupit me lidhje me dhurata dhe argëtim dhe duhet të angazhohet që:

- ◆ Të respektojë kufijtë dhe ndalimet e përcaktuara në politikën e brendshme të Grupit, siç detajohet në çdo vend ku Grupi është aktiv
- ◆ Të sigurohet që marrja apo ofrimi i dhuratave apo argëtimeve është e ligjshme
- ◆ Të kërkohet autorizim nga Pajtueshmëria për çdo përjashtim nga politika e Grupit
- ◆ Të regjistrohet në ekipin e Pajtueshmërisë çdo dhuratë apo argëtim që është përtej sasisë së arsyeshme të identifikuar



Një klient imi afatgjatë sapo më ofroi bileta për një event të madh argëtues biletat e të cilit janë shitur komplet.

A mund t'i pranoj biletat?

Duhet t'i referoheni politikës për dhurata dhe argëtim të BNP Paribas Group, e cila përcakton në detaje kriteret për pranimin e mikpritjes. Nëse ende jeni i paqartë, atëherë duhet të konsultoheni me menaxherin tuaj, ose zyrtarin lokal të Pajtueshmërisë.



5

RESPEKTI PËR KOLEGËT

BNP PARIBAS GROUP ASPIRON TË NXISË NJË MJEDIS PUNE STIMULUES KU NJERËZIT TRAJTOHEN NË MËNYRË TË DREJTË, DHE PRET NGA TË GJITHË PUNONJËSIT TË SHFAQIN SJELLJE PROFESIONALE NË ÇDO RRETHANË.

ZBATIMI I STANDARDEVE MË TË MIRA TË SJELLJES PROFESIONALE

Secili ka përgjegjësi të sillet profesionalisht dhe me përgjegjësi me njerëzit, që do të thotë se ne angazhohemi të:

- ◆ Të jemi pro-aktive në njohjen dhe pajtueshmërinë me politikat e përhershme të Grupit, procedurat dhe udhëzimet e tjera të dhëna nga menaxhmenti në lidhje me aktivitetet tona profesionale
- ◆ Të respektojmë rregullat e zbatueshme të fshehtësisë profesionale në çdo kohë

- ◆ Trajtojmë të gjithë njerëzit me respekt
- ◆ Sigurojmë se ndërveprimet me njerëzit janë profesionale dhe efektive gjithë kohën
- ◆ Dëgjojmë dhe vlerësojmë kontributet e njerëzve, edhe nëse ata shprehin pikëpamje që mund të jenë të ndryshme nga tonat



***Si menaxher dhe drejtues,
si mund të nxis sjellje
të mirë në organizatë?***

Duhet të drejtoni përmes shembullit tuaj dhe të zbatoni standardet më të larta etike. Krijoni një mjedis të komunikimit të hapur dhe të ndershëm dhe inkurajoni diskutimin e etikës dhe integritetit në vendimet e biznesit në mbledhjet e ekipit. Bëjuni me dije punonjësve se munden dhe duhet të raportojnë çdo problem që kanë mbi sjelljen pa pasur nevojë të shqetësohen për ndonjë hakmarrje të mundshme.





Jam menaxher dhe kam dëgjuar diskutime të cilat sugjerojnë sjellje të pahijshme në një fushë tjetër të biznesit.

Nuk është përgjegjësia ime, por a duhet ta ngre shqetësimin?

Të gjithë kolegët, duke përfshirë edhe menaxherët, janë përgjegjës për ngritjen e ndonjë shqetësimi në lidhje me sjelljen, që mund të jetë në kundërshtim me ligjin, rregulloren apo Kodin e Sjelljes. Këtë shqetësim mund ta ngrini tek menaxheri juaj. Nëse nuk ju duket e përshtatshme, mund ta ngrini çështjen tek Pajtuueshmëria ose të përdorin kanalin e sinjalizimit (whistleblowing). Nuk ka hakmarrje për raportimin e shqetësimeve në qoftë se bëhet në mirëbesim.



MOSPRANIMI I ASNJË FORME TË DISKRIMINIMIT

Grupi BNP Paribas është i përkushtuar të ruajë një ambienti pozitiv pune ku të gjithë njerëzit trajtohen me respekt dhe dinjitet. Për të respektuar të tjerët, punonjësit nuk duhet të diskriminojnë asnjë person brenda grupit. Punonjësit duhet:

- ◆ Të promovojnë trajtim të barabartë të kandidatëve në procesin e rekrutimit, gjithmonë ta bazojnë gjykimin mbi kompetencat dhe aftësitë e vlerësuar në mënyrë objektive, të sigurojnë mundësi të barabarta dhe të përcaktojnë kushtet e shpërblimit në mënyrë të drejtë dhe të barabartë.
- ◆ Të refuzojnë të gjitha format e diskriminimit, bullizmit ose ngacmimit ndaj punonjësve të tjerë, klientëve ose çdo personi me një lidhje me Grupin BNP Paribas bazuar në faktorë të ndaluar si gjinia, kombësia, shëndeti, paaftësia, mosha, identiteti (përfshirë origjinën etnike).



Kam dëgjuar një person duke iu referuar dikujt tjetër me gjuhë raciste.

Çfarë duhet të bëj?

Ju mund t'i thoni diçka drejtpërdrejt këtij personi nëse ndihesh rehat ta bësh këtë, por në çdo rast duhet të kontaktoni menaxherin dhe/ose departamentin e Burimeve Njerëzore ose të përdorin kanalin e sinjalizimit (whistleblowing) për të ngritur shqetësimin tuaj. Mund të jetë më e lehtë të kthehesh nga ana tjetër, por ne të gjithë kemi një përgjegjësi për të krijuar dhe për të ruajtur një mjedis të respektueshëm dhe bashkëpunues të punës.



- ◆ Nuk duhet të përfshihen në ngacmime seksuale ose të sillen në një mënyrë që mund të interpretohet si e tillë. “Ngacmim seksual” përkufizohet si çdo sjellje e natyrës seksuale që cenon dinjitetin e njerëzve, e cila mund të konsiderohet si e padëshiruar, e papranueshme, e papërshtatshme dhe fyese për marrësin, dhe që krijon një mjedis pune kërcënues, armiqësor, të paqëndrueshëm ose fyese.



Kam qenë dëshmitar i një personi që bënte komente të papërshtatshme seksualisht sugjestive ndaj një personi tjetër.

Çfarë duhet të bëj?

Gjithkush ka një rol për të luajtur në krijimin dhe ruajtjen e një mjedisi pune në të cilin respektohet dinjiteti i tyre, ku viktimat e diskriminimit dhe ngacmimit nuk do të ndjejnë se ankesat e tyre injorohen ose zvogëlohen, e nuk do kenë frikë nga hakmarrja. Mund të bisedoni me personat e përfshirë nëse mendoni se është e përshtatshme; në çdo rast, duhet ta ngrenë çështjen tek menaxheri juaj dhe të kërkonj këshilla të veçanta nga përfaqësuesi juaj i Burimeve Njerëzore.



GARANTIMI I SIGURISË NË VENDIN E PUNËS

Grupi e konsideron sigurinë e vendit të punës si një fuqi kyç dhe është përgjegjësi e çdo punonjësi:

- ◆ Të marrë pjesë në promovimin e një mjedisi pune të sigurtë dhe të mbrojtur për aktivitetet e përditshme dhe në përputhje me politikën e brendshme të Grupit
- ◆ Të përpiqet të marrë masa për të përmirësuar kushtet e punës së ekipeve, kur vepron si menaxher
- ◆ Të raportojë çdo aktivitet që mund të nënkuptojë një kërcënim për sigurinë fizike të një punonjësi ose një personi të jashtëm që vepron në ambientet e BNP Paribas Group

6

MBROJTJA E GRUPIT

TË GJITHË PUNONJËSIT KANË OBLIGIM TË MBROJNË DHE RUAJNË QËNDRUESHMËRINË AFATGJATË TË BIZNESIT TË BNP PARIBAS GROUP. GRUPI PRITET TA MBAJË MENAXHIMIN E TIJ TË FORTË ME ORIENTIM AFATGJATË, KËSHTU QË DUHET VAZHDIMISHT TË PËRFORCOJË STABILITETIN E TIJ, NË INTERES TË VETË GRUPIT, TË AKSIONARËVE TË TIJ DHE TË EKONOMISË MË TË GJERË.

NDËRTIMI DHE MBROJTJA E VLERËS AFATGJATË TË BNP PARIBAS GROUP

Për të ndërtuar dhe mbrojtur vlerën afatgjatë të BNP Paribas Group, është thelbësore që:

- ◆ Të marrim pjesë në mbrojtjen e të gjitha asetëve të Grupit, duke përfshirë asetet fizike, teknologjike, intelektuale dhe asetet financiare, emrin e kompanisë, brendin dhe marrëdhëniet me klientët
- ◆ Të parandalojmë keqpërdorimin e këtyre mjeteve dhe burimeve për përfitim të ndonjë personi tjetër, qoftë vullnetarisht ose nga pakujdesia
- ◆ Ta vëmë gjithmonë suksesin afatgjatë mbi fitimin afatshkurtër për të mbrojtur brendin dhe reputacionin e BNP Paribas Group

KOMUNIKIMI I PËRGJEGJSHËM

Është detyrë e rëndësishme të komunikojmë me përgjegjësi në çdo kohë, pra:

- ◆ Asnjëherë nuk rrezikojmë reputacionin e bankës kur flasim me palë të jashtme ose për çdo subjekt në lidhje me BNP Paribas Group
- ◆ Asnjëherë të mos shkëmbehen informata të ndjeshme tregtare me konkurrentët
- ◆ Jemi në pajtim me politikën e brendshme të Grupit në lidhje me përdorimin e mjeteve digjitale dhe mediave sociale



Çfarë duhet të bëj nëse një gazetar më pyet për aktivitetet e BNP Paribas Group?

Të gjitha kërkesat nga mediat duhet t'u drejtohen pa koment Marrëdhënieve me Media. Përveç kësaj, duhet miratimi i menaxherit tuaj dhe Marrëdhënieve me Mediat përpara se të bëni ndonjë paraqitje në media apo të mbani fjalime në mjedise të jashtme si punonjës i BNP Paribas Group.





Unë punoj për një entitet të Grupit BNP Paribas që ushtron një aktivitet jobankar. Më duhet të marr pjesë në një takim ku përfshihen disa nga konkurrentët e mi.

A zbatohen rregullat e ligjit të konkurrencës?

Po, ligji i konkurrencës zbatohet për të gjithë punonjësit e Grupit BNP Paribas, pavarësisht nga aktiviteti në fjalë, ose nëse ai është i rregulluar apo jo..



MBROJTJA E INFORMACIONIT TË GRUPIT

Është me rëndësi kritike të mbrohen informatat e Grupit në të gjitha rrethanat. BNP Paribas Group i besohen vazhdimisht një sasi tepër e madhe e të dhënave të ndjeshme që përbëjnë një nga asetet strategjike, kritike për aktivitetet e tij. Përdorimi i teknologjive të reja të menaxhimit të të dhënave (p.sh. Cloud, të dhënat e mëdha) dhe aplikimet digjitale (rrjetet sociale, e-mail...) krijojnë burime të reja të rreziqeve, të tilla si rreziqet e sigurisë kibernetike. Grupi duhet të jenë i përgatitur për t'u përballur me kërcënimin e këtyre rreziqeve dhe përpjekjeve për të dëmtuar integritetin e të dhënave të tij. Në këtë kuadër, Grupi mbështetet në çdo punonjësi që:

- ◆ T'u përmbahet standardeve më të larta të sigurisë së informacionit
- ◆ Të mbrojë dhe sigurojë të gjitha të dhënat dhe informacionin konfidencial në lidhje me klientët, punonjësit, bankën, dhe njerëz e organizata të tjera
- ◆ Të garantojë përdorim, qasje, ruajtje, zbulim, transferim dhe fshirje të kujdesshme dhe të përshtatshme të këtyre të dhënave në çdo kohë, duke përfshirë të dhënat online.



VEPRIMI ETIK ME PALËT NGA JASHTË

Mbrojtja e Grupit përfshin veprimin etik me palët e jashtme, pra ne:

- ◆ Kërkojmë marrëdhënie reciproke përfituese me furnizuesit e Grupit, në mënyrë që të nxisim sjelljen etike përgjatë zinxhirit të furnizimit dhe të parandalojmë rreziqet që lidhen me varësitë reciproke
- ◆ Jemi në pajtim me kontrollet e brendshme, politikat dhe procedurat e Grupit në lidhje me furnizuesit
- ◆ Respektojmë ligjet e konkurrencës për të promovuar konkurrencën e lirë dhe të ndershme midis këtyre aktorëve të tregut, pavarësisht nga tregjet në fjalë (të rregulluara dhe të parregulluara)



Kam vënë re në shtyp se një menaxher i një prej furnizuesve tanë është i përfshirë në një skandal korrupsioni.

Çfarë duhet të bëj?

Ju duhet menjëherë të ngrini këtë çështje te menaxheri juaj dhe ekipi i Prokurimit. Furnizuesit e Grupit duhet të zbatojnë të njëjtat standarde etike si vetë Grupi. Është e mundshme që Prokurimit tashmë është në dijeni të çështjes dhe po e shqyrton furnizuesin, por është më mirë të gabosh nga kujdesi i shtuar në interes të Grupi.



MARRJA E RREZIQEVE NË MËNYRË TË PËRGJEGJSHME DUKE SIGURUAR KONTROLL NGA AFËR TË RREZIKUT

Ndërgjegjësimi i rrezikut, menaxhimi i rrezikut dhe kontrolli i rrezikut janë thelbësorë për të mbrojtur Grupin. Komitetet e dedikuar sigurohen që vendimet më të mira merren në mënyrë kolektive (p.sh. Komiteti i kredisë, Komiteti i aktivitetit të ri, etj.), me procese formale të përshkallëzimit të vendosura. Gjithkush ka një rol të rëndësishëm për të vepruar me përgjegjësi në këto çështje në zonat e tyre të përgjegjësisë. Prandaj, e kemi detyrë:

- ◆ Të veprojmë në përputhje me praktikën e më të mirë të BNP Paribas Group në pajtueshmëri, parandalim të mashtrimit, si dhe menaxhim të rrezikut dhe kontrole të brendshme në përgjithësi
- ◆ Të bëjmë çdo përpjekje për të parashikuar rreziqet që mund të lindin në aktivitetet e përditshme
- ◆ Të jemi të angazhuar për të kontrolluar rrezikun në mënyrë rigorozë me qëllim mbrojtjen e klientëve dhe sistemit financiar në tërësi
- ◆ Të kuptojmë dhe të ndjekim një proces rigoroz dhe të koordinuar, të bazuar në një kulturë të fortë e të përbashkët të rrezikut, i cili përshkon të gjitha nivelet e Grupit, para se të marrim ndonjë vendim apo të përkushtohemi
- ◆ T'i monitorojmë dhe balancojmë në mënyrë aktive rreziqet dhe rezultatet që materializohen



Nuk jam dakord me një koleg nëse një transaksion i pazakontë me ekspozimin rreziku të lartë kërkon përshkallëzimin.

Çfarë duhet të bëj?

Banka ka standardet dhe proceset që ju ndihmojnë të identifikoni dhe të veproni për transaksionet që kërkojnë shqyrtim më nga afër. Transaksionet e pazakonshme ose me rrezik të lartë i referohen komiteteve të themeluara dhe me përvojë të miratimit, që ndihmojnë për të mbrojtur firmën dhe klientët e saj. Grupi e vlerëson kujdesin ndaj rrezikut, dhe duhet të flisni gjithmonë kur keni dyshime. Nëse besoni se transaksioni kërkon përshkallëzim atëherë duhet ta ngrini çështjen me menaxherin tuaj dhe funksionet përkatëse të kontrollit. Ngritja e shqetësimit do të thotë se transaksioni është shqyrtuar më tej, çka mbron grupin dhe të gjithë të përfshirët.



RUAJTJA E PËRGJEGJËSISË KUR LARGOHESH NGA BNP PARIBAS GROUP

Edhe kur largohet nga BNP Paribas Group, secili punonjës ende ka një përgjegjësi ndaj Grupit dhe klientëve të tij, prandaj ata duhet:

- ◆ Të mos transferojnë kurrë informacionin (p.sh. të dhëna, dosje, dokumente), i cili i përket BNP Paribas Group, në një vend të jashtëm, kur largohen nga Grupi
- ◆ Të mos mbajnë kurrë dokumentet që i përkasin BNP Paribas Group pas largimit nga Grupi
- ◆ Të jeni në pajtim me politikën e brendshme të Grupit dhe detyrimin personal për të mos krijuar konkurrencë të pandershme, nëse është e aplikueshme.



PËRFSHIRJA ME SHOQËRINË

GRUPI BNP PARIBAS ASPIRON TË JETË KONTRIBUUES NË ZHVILLIM TË PËRGJEGJSHËM DHE TË QËNDRUESHËM GLOBAL. AMBICIA E TIJ ËSHTË TË JETË LIDER NË FINANCA TË QËNDRUESHME DHE TË KETË NDIKIM POZITIV NË SHOQËRI SI TËRËSI, SI NË VETË OPERACIONET E TIJ DHE PËRMES PRODUKTEVE DHE ZGJIDHJEVE QË BIZNESET E TIJ U OFROJNË KLIENTËVE TË TYRE. KY SEKSION I RREGULLAVE TË SJELLJES DETAJON RREGULLAT DHE KËRKESAT PËR PUNONJËSIT E GRUPIT BNP PARIBAS PËR T’I MBËSHTETUR KËTO ASPIRATA.



PROMOVIMI I RESPEKTIT PËR TË DREJTAT E NJERIUT

BNP Paribas Group është i angazhuar për të siguruar respektimin e të drejtave të njeriut brenda sferës së vet të influencës, që do të thotë në mesin e punonjësve, furnizuesve, klientëve dhe komuniteteve në të cilat operon Grupi. Grupi sidomos nuk dëshiron të përfshihet në asnjë shkelje të mundshme të të drejtave të njeriut përmes aktiviteteve të veta të financimit dhe investimeve.

Punonjësit e BNP Paribas Group pritët të mbështesin respektimin e të drejtave të njeriut dhe në veçanti:

- ◆ Gjithmonë të marrin në konsideratë ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të veprimtarisë së tyre në të drejtat e njeriut në mbarë botën
- ◆ Të sigurojnë pajtueshmërinë me kriteret që lidhen me ndikimin në të Drejtat e Njeriut të kompanisë/projektit, kur veprojnë në sektorët e mbuluar nga politika PSK e financimit dhe investimeve⁸



Një nga klientët e mi, një grup shpërndarjeje me operacione në shumë vende, përballët me akuza për bashkëpunim në shkelje të të drejtave të njeriut. Një nga furnizuesit kryesorë të tij akuzohet nga OJQ-të për përdorimin e punës së detyruar në fabrikat e tij. Organizatat e shoqërisë civile dhe figurat me ndikim tashmë kanë ushtruar presion publik ndaj institucioneve të tjera financiare për t'i dhënë fund marrëdhënieve me këtë klient.

Çfarë duhet të bëj?

BNP Paribas ka krijuar një kornizë të fortë për menaxhimin e rreziqeve MSQ (Mjedis, Social dhe Qeverisje) në lidhje me financimin dhe aktivitetet e saj investuese. Në zbatim të kësaj të fundit, ky klient kontrovers duhet të kontaktohet sa më shpejt për të verifikuar themelin e akuzave ndaj tij. Nëse ky dialog bën të mundur identifikimin e shkeljeve të kërkesave të MSQ-së të shprehura nga Grupi, duhet të hartohet një plan korrigjimi dhe zbatimi i tij të monitorohet në intervale të rregullta, nga menaxheri i marrëdhënieve, i cili, nëse është e nevojshme, mund të mbështetet në personin e kontaktit të PSK-së të entitetit të tij ose të saj si dhe ekspertizën kolektive të rrjetit të PSK-së të BNP Paribas.



MBROJTJA E MJEDISIT DHE LUFTA KUNDËR NDRYSHIMEVE KLIMATIKE

Grupi BNP Paribas përpiqet të kufizojë çdo ndikim mjedisor që rezulton indirekt nga aktivitetet e tij financuese dhe investuese ose drejtpërdrejt nga operacionet e tij. Në këtë kontekst, Grupi e konsideron luftën kundër ndryshimeve klimatike prioritet dhe është i përkushtuar të menaxhojë biznesin e tij, të financojë tranzicionin drejt një ekonomie me zero karbon deri në vitin 2050 (Aleanca Net-Zero Banking⁹), në veçanti duke mbështetur klientët e tij në energjinë dhe tranzicionet e tyre ekologjike. Punonjësit e Grupit BNP Paribas kanë përgjegjësi të:

- ◆ Gjithmonë të marrin në konsideratë ndikimet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta mbi mjedis të veprimtarisë së tyre në mbarë botën
- ◆ Të sigurojnë pajtueshmërinë me kriteret që lidhen me ndikimin në mjedis të kompanisë/projektit, kur veprojnë në një sektor të mbuluar nga politika PSK e financimit dhe investimeve¹⁰
- ◆ Në mënyrë aktive të kontribuojë në arritjen e objektivave të përcaktuara nga Grupi për të reduktuar ndikimin e operacioneve të saj të përditshme në mjedis

9 – Në vitin 2021, BNP Paribas u bë nënshkruese e Aleancës Net-Zero Banking, një grup prej 57 bankash të angazhuara për të përfunduar emetimet e gazeve serrë të krijuara nga kreditimi i tyre dhe nga aktivitetet e tyre investuese me trajektoren e kërkuar për të arritur neutralitetin e karbonit deri në vitin 2050. Nënshkruësit marrin përsipër të përcaktojnë objektiva të ndërmjetëm dhe të publikojnë progresin e tyre dhe planet e veprimt që lidhen me to çdo vit.

10 – <https://group.bnpparibas/en/financing-investment-policies>



Më ka kontaktuar një tregtar i mallrave bujqësore (fruta ekzotike, fasule soje, misër) për të financuar një nga transaksionet e tij.

Çfarë duhet të bëj?

Sektori i bujqësisë mbulohet nga një politikë e PSK-së financimi dhe investimi. Kjo politikë u forcua në vitin 2021 për të luftuar shpyllëzimin në Amazon dhe Cerrado të lidhur me prodhimin e gjedhit dhe sojës. Prandaj, duhet të kontaktoni zyrtarin tuaj lokal të PSK-së për të kontrolluar se si ta vlerësoni këtë kompani në lidhje me kriteret e politikës (të drejtat e njeriut, mbrojtja e mjedisit, etj.) dhe kërkesat e reja në lidhje me shpyllëzimin. Në këtë rast specifik, është e rëndësishme të vihet në dyshim kjo kompani për origjinën e kokrrave të tregtuara të sojës dhe për strategjinë e saj për të zhdukur shpyllëzimin në zinxhirin e saj të furnizimit me fasule soje deri në vitin 2025 më së voni, nëse vjen nga pellgjet e Amazonës ose Cerrado-s.



VEPRIMI ME PËRGJEGJËSI NË PËRFAQËSIMIN PUBLIK

BNP Paribas Group synon të japë kontribut konstruktiv për procesin demokratik duke iu ofruar vendim-marrësve publikë, në përputhshmëri të plotë me rregullat ligjore dhe etike, informacion që asiston diskutimet e tyre dhe i ndihmon të marrin vendime të drejta dhe të informuara. Prandaj, ekziston detyrimi për të vepruar me përgjegjësi në lidhje me autoritetet publike.



KONTRIBUIMI NË SHOQËRI MË GJITHËPËRFSHIRËSE

Grupi përdor të gjitha levat që ka në dispozicion, si ofrues, punëdhënës dhe mbrojtës i shërbimeve financiare dhe investimeve, për të promovuar zhvillimin e qëndrueshëm dhe harmonik të shoqërisë. Ai vepron në veçanti për të nxitur zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të rajoneve. Grupi gjithashtu përpiqet t'u kushtojë vëmendje të veçantë klientëve në situata të cenueshme dhe të lehtësojë qasjen e tyre nëpërmjet zhvillimit të produkteve dhe shërbimeve financiare të përshtatura dhe të qasshme. Punonjësit e Grupit BNP Paribas duhet të sigurojnë që ata të marrin parasysh ndikimin social të aktiviteteve të tyre.

KODI I MIRËSJELLJES NË PRAKTIKË

KODI I MIRËSJELLJES OFRON QARTËSI PËR TË GJITHË PUNONJËSIT NË LIDHJE ME ATË QË PRITET PREJ TYRE GJATË USHTRIMIT TË ROLEVE DHE PËRGJEGJËSIVE TË TYRE. VLERËSIMI VJETOR I PERFORMANCËS U MUNDËSON MENAXHERËVE TË PËRFORCOJNË RËNDËSINË E “JETËSIMIT TË VLERAVE” DHE TË NXJERRIN NË PAH SJELLJET E DUHURA, ASHTU SIÇ JANË PËRSHKRUAR NË KODIN E MIRËSJELLJES, PËR ANËTARËT E TYRE TË EKIPIT.

Këto sjellje do të kontribuojë gjithashtu në gjenerimin e më shumë qartësie dhe transparence për punonjësit mbi “standardet e përgjithshme etike” që priten nga BNP Paribas Group dhe nga autoritetet përkatëse rregullatore. Trajnimi (e-learning), i zhvilluar dhe realizuar për të gjithë stafin, i ndihmon punonjësit për të përmbushur rolet dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me prioritetet e përcaktuara në Kodin e Mirësjelljes. Të gjithë punonjësit e grupit kanë për detyrë:

- ◆ Të njohin dhe të jenë në pajtim me të gjitha rregullat e sjelljes të përfshira në Kod
- ◆ Të jenë vigjilentë dhe t’i sfidojnë të tjerët nëse ata nuk veprojnë në frymën e Kodit
- ◆ Të kalojnë të gjitha trajnimet e nevojshme dhe të identifikuar për të kuptuar përgjegjësitë e tyre
- ◆ Të përdorin procedurën e sinjalizimit (Whistleblowing) të Grupit për të folur dhe për të ngritur shqetësimet e tyre kur është e nevojshme
- ◆ Të veprojnë dhe të kryejnë biznes në përputhje me Kodin në të gjitha aspektet e rolit të tyre

BNP Paribas Group është i angazhuar për të vlerësuar dhe shpërblyer njerëzit që mishërojnë vlerat e tij dhe janë shembull në aspektin e jetësimit të Kodit të Mirësjelljes. Po ashtu, Grupi nuk do t’i tolerojë shkeljet e Kodit të Mirësjelljes. Masat e duhura do të merren ndaj punonjësve që dështojnë në jetësimin e Kodit të Mirësjelljes në përputhje me ligjet vendore, rregulloret lokale dhe politikën e Burimeve Njerëzore të Grupit.¹¹

¹¹ - Including the document ‘Reglement Interieur de BNP Paribas SA’ in France

MARRJA E VENDIMEVE

TEKSA RREGULLAT E SJELLJES MUND TË NDIHMOJNË MARRJEN E ÇDO VENDIMI, NUK KA NJË RREGULL PËRKATËS PËR ÇDO SITUATË. NË FUND TË FUNDIT, MARRJA E VENDIMIT TË DREJTË DUHET TË MBËSHTETET NË GJYKIMIN PERSONAL DHE VLERAT E GRUPIT. NËSE AJO QË KENI NDËRMEND TË BËNI NUK ËSHTË NË PËRPUTHJE ME KËTO, DUHET TA PYESNI VETEN PSE DUHET TA BËNI.



A është e ligjshme?



*A është në përputhje me
politikat dhe Kodin
e Mirësjelljes së Grupit?*

PARA SE TË
VEPRONI,
PYETNI VETEN



*A është e bazuar në
një kuptim të plotë
të rreziqeve të përfshira?*



*A jam i sigurt se nuk do të
dëmtojnë besimin e klientëve,
aksionarëve dhe shoqërisë*



*A do ta kisha të thjeshtë
t'ia shpjegoja këtë vendim
një pale të tretë?*

NËSE PËRGJEGJJANË DONJËPREJKËTYRE PYETJEVE ËSHTËJO, NDALU DHE FOL!

Nëse keni ndonjë shqetësim apo dyshim, kërkoni udhëzim nga autoriteti përkatës: manaxheri juaj i linjës, menaxheri i lartë, zyra ligjore apo e pajtueshmërisë.

SI PËRSHTATET KODI ME LIGJET VENDORE DHE NDËRKOMBËTARE?

TË GJITHË TË PUNËSUARIT PRITEN QË T'I NJOHIN STANDARDET NDËRKOMBËTARE, DHE TË JENË NË PAJTIM ME LIGJET, RREGULLAT DHE RREGULLORET E APLIKUESHME NË TË GJITHA FUSHAT, DHE ME STANDARDET PROFESIONALE QË ZBATOHEN PËR AKTIVITETET E TYRE PROFESIONALE.

Për të siguruar stabilitetin e sistemit financiar, industria në të cilën punojmë në është shumë e rregulluar. Të qenët i vetëdijshëm dhe në pajtim me ligjet dhe rregullat sipas të cilave operon Grupi nuk është vetëm një pjesë e rëndësishme e biznesit tonë, por themelore për atë që ne përfaqësojmë. Ne synojmë ta përmbushim ligjin jo thjesht me pikë e me presje, por edhe me frymën dhe qëllimin e ligjit. Respektimi i ligjit është domosdoshmëri. Kryerja e veprimeve ose praktikave të padrejta, mashtruese dhe abuzive ndikon negativisht në besimin e klientëve, vë në rrezik reputacionin e Grupit dhe mund të rezultojë në kritika të rregullatorit, veprime ligjore, gjoba, dënimet dhe pasoja të tjera negative për Grupin.

BNP Paribas Group është i përkushtuar për të bashkëpunuar gjithmonë me organet relevante rregullatore.

Nëse keni pyetje në lidhje me ligjet dhe rregulloret që zbatohen për aktivitetin tuaj, ose për llojin e reagimit që i duhet ofruar një organi rregullator, kontaktoni pajtueshmërinë përkatëse, zyrtarin tuaj ligjor ose tatimor, për ndihmë dhe këshilla.

Kodi i Mirësjelljes artikulon çka pritet nga secili prej nesh; pra sjellja më e mirë, brenda kuadrit të ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në tregjet në të cilat Grupi bën biznes. Në rast të mundshëm të një konflikti ndërmjet legjislacionit kombëtar dhe rregullave të përfshira në Kod, BNP Paribas Group do të jetë në pajtim me ligjet e aplikueshme lokale dhe do të përpiqet të identifikojë mënyrat e duhura për të zbatuar dhe respektuar rregullat e Kodit. Kur një situatë kërkon interpretim nga ana e punonjësve të Grupit, duhet të bëhet në një mënyrë që është në përputhje me kriteret më të rrepta etike të zbatueshme.

SHPREHJA DHE NGRITJA E SHQETËSIMEVE

GRUPI BNP PARIBAS ËSHTË SHUMË I VËMENDËSHËM NDAJ SHQETËSIMEVE TË KLIENTËVE, FURNIZUESVE, PUNONJËSVE, AKSIONARËVE DHE KOMUNITETIT MË TË GJERË. GRUPI ËSHTË I PËRKUSHTUAR TË DËGJOJË, KUPTOJË DHE KËRKOJË ADRESIM TË SHQETËSIMEVE TË NGRITURA NGA PALËT TONA TË INTERESIT NË MËNYRË TË DREJTË DHE EFEKTIVE.

Si punonjës, nëse jeni dëshmitar ose dyshoni për një shkelje të Kodit të Sjelljes, për shembull, vëreni trajtim të pabarabartë midis dy klientëve që përndryshe duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, ose mashtrim të brendshëm, ose dyshoni për një akt korrupsioni (përfshirë ushtrimin e ndikimit) ose një praktikë kundër-konkurruese, ose jeni dëshmitar i një akti diskriminimi, ose ngacmimi, etj., duhet ta raportoni atë.

Disa kanale janë në dispozicion për ju¹²:

1 Menaxheri juaj i linjës (menaxheri juaj i drejtpërdrejtë në baza ditore) ose një menaxher i nivelit më të lartë në fushën tuaj të aktivitetit, nëse keni problem të flisni me menaxherin tuaj të linjës.

Për shembull, një nga kolegët tuaj ka ndarë me ju informata negative për subjektin e menaxherit të një kompanie klient, për të cilat ai ishte vënë në dijeni përmes një marrëdhënieje personale dhe që mund të ndikojë në një proces vendimmarrjeje. Ju mendoni se këto informata janë konfidenciale: diskutoni ato me menaxherin tuaj.

2 Kanalet e BNj-ve, të rregulluara me procedura në lidhje me sjelljen që nuk është në përputhje me Kodin e Sjelljes në dispozitat e tij në lidhje me respektimin e kolegëve, në rast të një shkeljeje të dyshuar ose të provuar të rregullave në lidhje me respektimin e kolegëve.

3 Kanalet e brendshme të sinjalizimit të Grupit, në përputhje me procedurën e sinjalizimit, duke përfshirë rregullat specifike të konfidencialitetit dhe dispozitat e përcaktuara në faqen e Grupit Echonet¹³.

Për shembull, ju keni mësuar se një punonjës i një departamenti bashkimi ose blerje i BNP Paribas ishte ndërmjetës, në një kapacitet personal, për shitjen e një kompanie për të cilën e kishit prezantuar menaxherin.

Ngritja e një sinjali alarmues është e drejtë e punonjësit dhe asnjë punonjës nuk do të jetë subjekt i hakmarrjes, si p.sh.: ndëshkimit, shkarkimit ose trajtimit diskriminues, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për sinjalizimin në përputhje me praktikën më të mira dhe në mirëbesim.

12 – Procedurë e sistemit të sinjalizimit e Grupit CPL0038FR

13 – <https://echonet.bnpparibas/pages/5ddbdee47135fc36152b47a2>

PËRGJEGJËSITË SHITESË PËR MENAXHERËT

**MENAXHERËT KANË PËR DETYRË TË UDHËHEQIN PËRMES
SHEMBULLIT DHE TË RUAJNË STANDARDET MË TË LARTA TË SJELLJES,
DUKE U SIGURUAR QË KËTO STANDARDE JANË TË QARTA DHE
TRANSPARENTE PËR VARTËSIT E VET.**

Ata duhet:

- ◆ Të krijojnë një atmosferë që inkurajon komunikim të hapur, të ndershëm dhe të respektueshëm
- ◆ Të komunikojnë përmbajtjen dhe frymën e Kodit tek vartësit e tyre dhe kolegët e tjerë
- ◆ Të zbatojnë procedurat e Grupit për të inkorporuar shtrirjen dhe zbatimin e Kodit si një faktor në menaxhimin e performancës
- ◆ Të kuptojnë në mënyrë aktive rreziqet e natyrshme në punën e kolegëve të tyre dhe të marrin rol në sigurimin e cilësisë së punës së vartësve të tyre
- ◆ Të jenë shembull për komunikim të sinqertë dhe të respektueshëm me klientët, kolegët dhe njerëzit e tjerë që lidhen me BNP Paribas Group, duke respektuar rregullat e zbatueshme të konfidencialitetit
- ◆ T'i përgjigjen në mënyrë efektive dhe të shpejtë çdo shqetësimi të ngritur nga kolegët dhe të ndërmarrin veprime të shpejta kur zbulohet çdo gabim apo sjellje e pahijshme

D

SHTOJCË



KODI I SJELLJES:
LUFTIMI I
KORRUPSIONIT

PËRMBLEDHJE

SHTOJCË

A	SJELLJET QË DUHET TË SHMANGEN, QË PËRCEPTOHEN SI RYSHFET OSE USHRTIM NDIKIMI	40
B	PARIMET THEMELORE KUNDËR KORRUPSIONIT DHE MASAT PËR LUFTIM TË USHTRIMIT TË NDIKIMIT	41
C	ILUSTRIME TË SJELLJEVE TË NDALUARA QË PERCEPTOHEN SI RYSHFET OSE USHTRIM NDIKIMI	42
1	Konfliktet e interesit	42
2	Dhurata, ftesa dhe shpenzime hotelierie	44
3	Pagesa lehtësimi	45
4	Konfidencialiteti i të dhënave	46
5	Patronazhi, donacionet dhe sponsorizimi	46
6	Përfaqësimi i interesave (lobimi)	47
7	Rekrutimi	49
8	Rreziqet e ndërlidhura me klientët, furnizuesit dhe ndërmjetësit	49

Kjo shtojcë Kundër Korrupsionit në Kodin e Sjelljes zbatohet për të gjithë punonjësit e Grupit (përfshirë punonjësit e jashtëm) në të gjitha nivelet e organizatës, të cilët duhet të sigurojnë pajtueshmërinë me të gjitha procedurat dhe kontrollet relevantet në të gjitha rrethanat, veçanërisht ato që kanë të bëjnë me sigurinë financiare dhe etikën profesionale (shih kapitujt “Siguria financiare” dhe “Etika profesionale” e Kodit të Sjelljes të Grupit, më sipër).

Shtojca Kundër Korrupsionit në Kodin e Sjelljes është një dokument publik i qasshëm për publikun e gjerë, duke përfshirë partnerët e BNP Paribas.

A

— SJELLJET QË DUHET TË SHMANGEN, — QË PËRCEPTOHEN SI RYSHFET OSE USHTRIM NDIKIMI

SHTOJCA KUNDËR KORRUPSIONIT NË KODIN E SJELLJES E GRUPIT BNP PARIBAS PËRCAKTON DHE ILUSTRON SJELLJET E NDALUARA, KU SJELLJE TË TILLA KARAKTERIZOJNË AKTET E KORRUPSIONIT APO USHTRIMIN E NDIKIMIT (KËTU E TUTJE I REFERUAR SË BASHKU SI “KORRUPSION”, OSE VEÇMAS SI “KORRUPSION” DHE “USHTRIM I NDIKIMIT”).

KORRUPSIONI

Korrupsioni ekziston kur një person propozon, ofron, premtan, autorizon, jep, kërkon ose pranon, drejtpërdrejt ose tërthorazi, për përfitimin e tij ose të një pale të tretë, një avantazh të padrejtë (për shembull, një dhuratë ose kompensim) për kryerjen, lehtësimin ose mosveprimin e një akti brenda fushëveprimit të detyrave të tij/saj.

Korrupsioni përfshin ndërveprimin e të paktën dy personave, qoftë fizikë ose juridikë, publikë ose privatë. Korrupsioni thuhet se është aktiv kur korrupsioni ofron një avantazh të padrejtë, ndërsa ka korrupsion pasiv kur personi i komprometuar pranon ose kërkon avantazh të padrejtë. Korrupsioni mund të jetë i tërthortë, kur ai përfshin ose përfiton një palë e tretë ose një ndërmjetës.

Në një manifestim të vetëm korrupsioni, akte aktive dhe pasive

korrupsioni dënohen në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri (njëri mund të dënohet edhe nëse tjetri nuk është provuar). Përfundimisht, korrupsioni dënohet rëndë kur kryhet nga një zyrtar publik¹⁴.

USHTRIMI I NDIKIMIT

Ushtrim i ndikimit ndodh kur një zyrtar publik ofron, kërkon ose pranon çdo avantazh për të abuzuar ndikimin e tij/saj real ose të perceptuar për të marrë një vendim ose situatë nga një autoritet ose administratë publike.

Ashtu si korrupsioni, ushtrimi i ndikimit mund të jetë aktiv (kur propozohet), ose pasiv (kur kërkohet ose pranohet).

Ndërsa pala e kompromentuar vepron, ose përmbahet nga veprimi, në ushtrimin e funksioneve të tij/saj, kryesi i ushtrimit të ndikimit përdor ndikimin e tij/saj mbi personin që ka fuqi për të vepruar ose të përmbahet

nga veprimi. Për shembull, ushtrimi i ndikimit konsiston në premtimin e diçkaje, jo në mënyrë që ai ose ajo mund të kryejë akte si pjesë e detyrave të tij/saj ose e lehtësuar nga kjo, por në mënyrë që ai ose ajo të mund ta përdorë ndikimin e tyre (qoftë real apo të perceptuar) me një palë të tretë për të marrë vendim ose opinion të favorshëm.

Punonjësit e Grupit BNP Paribas nuk duhet në asnjë rrethanë të marrin pjesë drejtpërdrejt ose tërthorazi, në akte korrupsioni ose ushtrimi ndikimi, të cilat janë të ndaluara me ligj dhe me këtë shtojcë të Kodit të Sjelljes.

Si institucion financiar, Banka mund të ekspozohet edhe ndaj akteve të ryshfetit ose ushtrimit të ndikimit që përfshin një palë të tretë. Punonjësit nuk duhet të vejnë Bankën në një pozicion ku kjo përfshihet në ndonjë transaksion ku ekziston rreziku i korrupsionit dhe/ose i pastrimit të parave.

¹⁴ – Zyrtar publik do të thotë çdo person që:

- posedon ose mban një pozitë ose funksion publik, veçanërisht zgjedhur, politik, administrativ ose gjyqësor, në një vend, qoftë i emëruar apo i zgjedhur (nëpunës civil, përfaqësues i zgjedhur lokal, deputet, gjyqtar, etj.);
- kryen një funksion publik për një vend, përfshirë për një shoqëri publike ose organ publik;
- i përket një organizate ndërkombëtare publike.

PARIMET THEMELORE KUNDËR KORRUPSIONIT DHE MASAT PËR LUFTIM TË USHTRIMIT TË NDIKIMIT

PËR BNP PARIBAS, KORRUPSIONI ËSHTË ABSOLUTISHT I PAPRANUESHËM, PAVARËSISHT RRETHANAVE. GRUPI BNP PARIBAS PËRBËHET RESPEKTON LIGJIN 'SAPIN II' TË 9 DHJETORIT 2016 NË LIDHJE ME TRANSPARENCËN, KUNDËR KORRUPSIONIN DHE MODERNIZIMIN E EKONOMISË, SI DHE ME AKTIN E RYSHFETIT NË MB, AKTIN E PRAKTIKAVE TË HUAJA TË KORRUPTUARA TË SHBA-VE (FCPA)¹⁵ DHE LIGJET E TJERA TË ZBATUESHME.

Grupi BNP Paribas ka definuar dhe zbatuar një sistem për zbulimin, parandalimin dhe luftimin e korrupsionit¹⁶ që përbëhet nga masat dhe procedurat e mëposhtme:

- ◆ Menaxhmenti i Grupit BNP Paribas ka politikë “zero tolerancë”, të qasshme për të gjithë¹⁷, në lidhje me korrupsionin dhe ushtrimin e ndikimit
- ◆ Qeverisje e përkushtuar, e mbështetur nga një rrjet ndërkombëtar i korrespondentëve kundër korrupsionit
- ◆ Program për zbulimin dhe parandalimin e korrupsionit, bazuar në strukturimin e rrezikut të përditësuar rregullisht
- ◆ Procedura dhe kontrolle që shqyrtohen rregullisht
- ◆ Kodi i Sjelljes i Grupit përfshirë Kodin e Sjelljes Kundër Korrupsionit
- ◆ Sistem i brendshëm sinjalizues
- ◆ Trajnim dhe fushata ndërgjegjësimi
- ◆ Regjim disiplinor në rast të shkeljeve të punonjësve

Grupi BNP Paribas, Drejtuesit e Lartë dhe të gjithë punonjësit e tij në të gjitha nivelet (përfshirë punonjësit e jashtëm) duhet jo vetëm të kenë zero tolerancë ndaj korrupsionit, por ata duhet ta luftojnë atë në mënyrë aktive. Kështu, çdo formë e korrupsionit është plotësisht e ndaluar dhe duhet të raportohet, jo vetëm aktet që përfshijnë një punonjës (qoftë për të përfituar personalisht qoftë për Grupin) por edhe aktet që mund të përfshijnë klientë ose partnerë tanë dhe që ne mund të vihem në dijeni gjatë një transaksioni të kryer si pjesë e aktiviteteve të Grupit BNP Paribas.

Përfshirja e punonjësit në një akt korrupsioni përbën sjellje të keqe profesionale. Çdo punonjës i cili vepron në kundërshtim me këtë Shtojcë të Kodit të Sjelljes është përgjegjës për masa disiplinore, pa paragjykuar ndjekje penale të mundshme.

Pavarësisht rrethanave dhe interesave në rrezik, parandalimi dhe zbulimi i korrupsionit është përgjegjësi e të gjithëve. Punonjësit e BNP Paribas jo vetëm që kanë detyrimin të përmbahen nga pjesëmarrja në çfarëdo akti korrupsioni, por edhe kanë për detyrë profesionale të bëjnë gjithçka brenda kompetencave të tyre për të ndihmuar në parandalimin e korrupsionit apo për t'i dhënë fund atij nëse aktet e korrupsionit ekzistojnë në vëmendjen e tyre.

A keni ndonjë pyetje në lidhje me Kodin e Sjelljes Kundër Korrupsionit? Kontaktoni menaxherin tuaj të linjës ose Pajtueshmërinë ose korrespondentin tuaj për kundër korrupsion në Pajtueshmëri

¹⁵ – Akti i praktikave të huaja korruptive (Shtetet e Bashkuara të Amerikës)

¹⁶ – Përmbledhje e masave kundër korrupsionit e BNP Paribas gjendet në linkun e mëposhtëm: https://group.bnpparibas/uploads/file/summary_updated_abc_policy_legal_edits_002.pdf

¹⁷ – Deklarata kundër korrupsionit nga Kryeshefi Ekzekutiv, gjendet në linkun e mëposhtëm: https://group.bnpparibas/uploads/file/statement_coc_va.pdf

ILUSTRIME

TË SJELLJEVE TË NDALUARA QË PERCEPTOHEN SI RYSHFET OSE USHTRIM NDIKIMI

ÇDO PUNONJËS QË ËSHTË NËN PRESION OSE QË BESON ARSYESHËM SE NJË SITUATË PËR TË CILËN JANË NË DIJENI, DREJTPËRDREJT APO TËRTHORAZI, NUK ËSHTË NË PAJTUESHMËRI ME NJË APO MË SHUMË PARIME TË PARAQITURA NË SHTOJCËN PËR KUNDËR KORRUPSIONIN NË KODIN E SJELLJES, DUHET TA RAPORTOJË ATË SA MË SHPEJT TË JETË E MUNDUR TEK MENAXHERI I TYRE I LINJËS OSE TEK PAJTUESHMËRIA.

1

KONFLIKTET E INTERESIT

Nëse kjo përfundimisht nuk është e mundur ose e përshtatshme, punonjësi mund të përdorë të drejtën e tyre të sinjalizimit në konfidencë, siç parashikohet në procedurën e Grupit “Sistemi i sinjalizimit” (i qasshëm nga databaza e procedurave)¹⁸. Sinjalizuesi mbrohet nga ligji dhe nga Sistemi i duhur i sinjalizimit i Grupit BNP Paribas dhe raportimi me mirëbesim nuk bëhet subjekt i hakmarrjes.

Çdo palë e tretë (klientë, partnerë, ndërmjetës, etj.) e kërkuar në mënyrë të padrejtë në kontekstin e marrëdhënieve të saj me Grupin BNP Paribas dhe subjekt i një akti në tentativë për korrupsion nga ndonjë punonjës i Grupit ftohet ta raportojë atë sa më shpejt që të jetë e mundur (shih më lart, në veçanti kapitullin “Shprehni mendimin tuaj dhe ngreni çështje” në Kodin e Sjelljes të Grupit).

Punonjësit duhet të ndjekin rregullat e brendshme për zbulimin, parandalimin dhe menaxhimin e konflikteve personale të interesit, për të parandaluar një interes personal nga ndikimi në veprimet apo vendimet e tyre dhe vendosja e tyre në një situatë të Korrupsionit (shih më lart, kapitulli “Menaxhimi i rrezikut të konfliktit të interesit” i Kodit të Sjelljes të Grupit, dhe procedurat “Politika e përgjithshme për menaxhimin e konflikteve të interesit”, “Politika e përgjithshme mbi konfliktet e interesit që përfshijnë punonjësit”, dhe “Procedura në lidhje me pozitat dhe aktivitetet private të jashtme të punonjësve të Grupit BNP Paribas” të qasshme nga databaza e procedurave).



Unë po kaloj një periudhë të vështirë në jetën time private dhe një nga klientët e mi më ofron të më japë para. Unë tundohej për të pranuar, sepse ne kemi një marrëdhënie besimi dhe unë sigurisht do t’ia kthejë atij.

May I accept my client’s kind offer?

Ndalohet marrja e parave nga klientët (ose ndonjë partner tjetër i BNP Paribas), veçanërisht pasi kjo mund t’ju vendosë në situatën e konfliktit të interesit dhe për rrjedhojë krijon vështirësi në kryerjen e detyrave tuaja në mënyrë të paanshme. Ju prandaj duhet ta refuzoni këtë propozim dhe të informoni menaxherin tuaj të linjës dhe Pajtueshmërinë.





Unë u emërova për të zgjedhur një furnizues për energji të gjelbër për ambiente të reja, ndërsa mbaj pozitë në njërën nga kompanitë ofertuese. Për organizimin e seminarit të ardhshëm vjetor, më ka.
Çfarë duhet të bëj?

Për të shmangur çdo konflikt interesi, mos merrni pjesë në procesin e përzgjedhjes dhe informoni menaxherin tuaj të linjës. Propozimi i kësaj kompanie do të studiohet si pjesë e procedurave të prokurimit.



Për organizimin e seminarit të ardhshëm vjetor, unë jam i tunduar të propozoj një hotel nga deti që i përket kumatit tim. Unë jam i sigurt se hijeshi i vendit do të jetë një hit, veçanërisht pasi që hoteli është më pak i shtrenjtë se hotelet konkurruese. Përveç kësaj do të ndihmojë edhe familjen!
A lejohet kjo?

Cilado qoftë cilësia e shërbimeve të ofruara nga marrëdhëniet tuaja personale, duhet të fillojë procesi i përzgjedhjes së furnizuesit. Nëse hoteli i kumatit/kumatës suaj është pjesë e përzgjedhjes, mos merrni pjesë në vendim, për të shmangur një konflikt interesi.



Një kontakt i mirë pune më ofron apartamentin e tij/saj personal në një resort bregdetar pa pagesë (dhe në mënyrë konfidenciale) për pushimet e mia të ardhshme. Unë jam vendimmarrësi për çështje të rëndësishme në lidhje me atë.
A mund ta pranoj këtë?

Jo, ju duhet ta refuzoni këtë propozim, i cili do t'ju vendoste në një konflikt interesi dhe që mund ndikojë në vendimet tuaja të ardhshme në këtë marrëdhënie dhe të perceptohet si avantazh të padrejtë. Informoni menjëherë menaxherin tuaj të linjës dhe Pajtueshmërinë.

2

DHURATA, FTESA DHE SHPENZIME HOTELIERIE

Dhuratat dhe ftesat e arsyeshme janë akte të zakonshme pune, të ofruara ato ofrohen ose pranohen si çështje mirësjelljeje ose për qëllime komerciale. Vlera, shpeshësia e tyre dhe, në përgjithësi, rrethanat në të cilat mund të pranohen ose të ofrohen janë të kufizuara në mënyrë që të parandalohen së perceptuar si konsideratë për avantazh të padrejtë ose si kusht për ushtrimin e ndikimit.

Prandaj është thelbësore të respektohen politikat e brendshme të Grupit BNP Paribas në lidhje me dhuratat dhe ftesat dhe ato që kanë të bëjnë me shpenzimet e mikpritjes (shih më lart, kapitulli “Etika profesionale” në Kodin e Sjelljes të Grupit, dhe procedurën “Politika e dhuratave dhe ftesave” e qasshme nga databaza e procedurave).

Pavarësisht rrethanave, dhe cilado qoftë mjeti i pagesës në fjalë, punonjësit nuk duhet të pranojnë ose japin para. Çdo pagesë e bërë dhe çdo shpenzim i bërë duhet të jetë legjitim, i justifikuar, i miratuar dhe i regjistruar në llogari. Punonjësit nuk duhet pasuritë e Grupit BNP Paribas të vënë në dispozicion pa autorizim të duhur.



Klienti vetëm më ka besuar në hapjen e llogarive për disa prej filialeve të tij, me kontrata të reja në rrezik. Unë do të dua të shpreh mirënjohjen time ndaj tij dhe falënderoj për besnikërinë e tij.

A mund t'i bëj një dhuratë, ose ta ftoj atë në një restorant të mirë?

Referojuni politikës së dhuratave dhe ftesave për të verifikuar shumat e autorizuar, dhe deklarojini ato menaxherit tuaj të linjës dhe Pajtueshmërisë.



Një shpërndarës i madh më fton mua, së bashku me partnerë të tjerë afarist, në një shtëpi luksoze që gjendet në një resort skish me të gjitha shpenzimet e paguara.

A mund ta pranoj këtë?

Kjo ftesë luksoze e tejkalon vlerën e parashikuar me procedura, dhe mund të ndikojë në vendimet tuaja në lidhje me këtë distributor. Prandaj ju duhet ta refuzoni atë, deklaroni këtë ftesë dhe informoni menaxherin tuaj të linjës, Prokurimin, dhe Pajtueshmërinë, në mënyrë që integriteti i këtij distributori të mund të rivlerësohet.



Një broker më ofron drekë në një restorant të mirë.

A mund ta pranoj këtë?

Ju duhet të vlerësoni nëse kjo ftesë është profesionale ose për kohën e lirë dhe referojuni procedurës aktuale për dhurata dhe ftesat.



Disa javë më vonë, i njëjti broker dërgon dy bileta teatri të klasit të parë në shtëpinë time. Karta e tij thotë: "Paçi një mbrëmje të mirë! Llogaris në ty për disa oferta të reja!"..

A mund ta pranoj këtë?

Ju duhet t'i refuzoni këto bileta dhe t'i ktheni ato. Përveç shumës, shpeshtësia e dhuratave dhe ftesat duhet t'ju paralajmërojnë për qëllimet e brokerit, veçanërisht kur ato ju dërgohen në shtëpi. Deklaroni ato dhe vlerësoni integritetin e palës së tretë me menaxherin tuaj të linjës dhe Pajtueshmërinë.



Sot në mëngjes, mora një paketë nga një furnizues i madh që kishte tableta më të fundit për secilin anëtar të komitetit tim.

A mund t'i mbaj ato?

Jo, ju duhet të refuzoni dhe të ktheni tabletat vlerën e të cilave tejkalon shumat e autorizuar dhe të cilat janë përgjegjëse për të ndikuar në gjykimin tuaj për këtë furnizues. Duhet ta informoni edhe menaxherin tuaj të linjës dhe Pajtueshmërinë, dhe rivlerësoni integritetin e këtij furnizuesi.





Do të doja të ftoja një klient në një ngjarje sportive ndërkombëtare të sponsorizuar nga BNP Paribas, por klienti ndodhet jashtë vendit dhe kostot e mikpritjes mund të jenë të larta.

A është e mundur kjo?

Një numër i madh klientësh janë të ftuar në këtë lloj të ngjarjeve për të promovuar brendin dhe imazhin e kompanisë. Ftesat janë të mundshme brenda kufijve të parashikuar me procedura. Ju duhet të merrni miratimin paraprak nga menaxheri juaj i linjës dhe Pajtueshmëria në lidhje me transportin dhe kostot e mikpritjes.



Klienti i moshuar me të cilin kam marrëdhënie të shkëlqyer më jep një zarf me para të gatshme.

Çfarë të bëj?

Ju duhet ta refuzoni atë. Çdo dhuratë parash janë të ndaluara. Më pas duhet t'i tregoni menaxherit tuaj të linjës që e keni refuzuar dhuratën dhe Pajtueshmëria e ka regjistruar atë.



3

PAGESA LEHTËSIMI

“Pagesa lehtësimiti” janë përgjithësisht shuma të vogla parash që i paguhen një zyrtari publik për të përshpejtuar (dhe për rrjedhojë “të lehtësojë”) përfundimin e disa formaliteteve administrative.

Punonjësve u ndalohejt t'u japin para në çfarëdo sasive shërbyesve publikë me qëllim të përshpejtimit ose zbutjes së ecures së procedurave administrative ose marrjes së autorizimeve si p.sh licencat, lejet etj.



Fluturimi im sapo ka ateruar katër orë pas planit. Dhjetëra pasagjerë janë në radhë për të marrë vizën e nevojshme hyrëse dhe tani do të jem vonë për një takim me një klient të rëndësishëm. Një zyrtar i emigracionit jep një këshillë të qartë se dhënia e disa kartëmonedha do të shkurtonte kohën e pritjes.

Çfarë duhet të bëj?

Ju duhet ta refuzoni propozimin sepse pagesat e lehtësimit janë të ndaluara, dhe informoni menaxherin tuaj të linjës dhe Pajtueshmërinë.



Jam kontaktuar nga një zyrtar i administratës pas parashtrimit të kërkesës për leje për rinovim të objektit afarist. Ai më thotë se kërkesa ime është në fund të grumbullit që ai ka për të përpunuar, dhe se një zarf i vogël do t'i mundësonte të përpunohej me prioritet.

Çfarë duhet të bëj?

Ju duhet ta refuzoni propozimin sepse pagesat e lehtësimit janë të ndaluara, dhe informoni menaxherin tuaj të linjës dhe Pajtueshmërinë.



4

KONFIDENCIALITETI
I TË DHËNAVE

Punonjësit nuk duhet nën asnjë rrethanë të zbulojnë informacione që i përkasin Grupit BNP Paribas ose marrëdhëniet e tij afariste, lëre më në këmbim të një avantazhi të padrejtë. Ngjashëm, ata duhet që në asnjë rrethanë të mos komunikojnë ose kërkojnë informata konfidenciale në lidhje me një projekt, transaksion, konkurrent, palë e tretë, etj., me synimin për të përfituar ose marrë një avantazh të padrejtë.

Shihni më sipër, kapitullin “Interesat e klientit” në Kodin e Sjelljes të Grupit, si dhe procedurat “Politika e përgjithshme e GRUPIT BNP Paribas për mbrojtjen e të dhënave personale – RISK0379” dhe “Politika globale për mbrojtjen e integritetit të tregut – CPL0241” e qasshme nga databaza e procedurave.



Përmes investimit “gjelbër”, klienti im do të diversifikojë rrjedhën e punës së tij dhe do të shfrytëzojë më pak Bankën... përveç nëse ai/ajo merr në mënyrë diskrete informacione konfidenciale për konkurrentët e tij/saj.

A jam i/e autorizuar për t’ia transmetuar këtë informacion konfidencial atij/asaj për të ruajtur ose rritur rrjedhën e punës për Bankën?

Është rreptësisht e ndaluar, në çdo rrethanë, të zbulohet informacioni konfidencial për një person jashtë Grupit BNP Paribas, veçanërisht informacioni në lidhje me një klient ose partner të tjetër të Grupit, e lëre më në këmbim të një avantazhi të padrejtë.



5

PATRONAZHI, DONACIONET DHE SPONZORIZIMI

Patronazhi dhe donacionet për organizatat që punojnë për interes të përgjithshëm ose social (shoqata kulturore, organizata humanitare, etj.), si dhe sponsorizimi i ngjarjeve ose projekteve (sportive, kulturore, etj.) mund të devijohet nga destinacioni i synuar kur ato përfshijnë pagesën ose marrjen e një avantazh të padrejtë, ose nëpërmjet keqpërdorimit të fondeve. Prandaj është thelbësore që të aplikohet një vlerësim për palët e treta/projektet (shih procedurat për vlerësimet të ndryshme të palëve të treta, të qasshme nga databaza e procedurave).

Në asnjë rrethanë nuk mund të bëhet patronazh, dhurim apo sponsorizim i tillë ose i dhënë si kusht për ushtrim ndikimi, ose me qëllim që të merret avantazh i padrejtë për Grupin BNP Paribas, punonjësit ose partnerët e tij. Në veçanti, “donacioni” për një

fondacion që i përket një personi të ekspozuar politikisht në lidhje me konkluzionin e një kontrate, duhet t’i nënshtrohet vigjilencës së veçantë. Nëse ka dyshime, punonjësit duhet të kërkojnë këshilla nga menaxheri i tyre i linjës ose Pajtueshmëria.



Në gazetën e mëngjesit zbuloj se fondacioni i ndihmës mjedisore në të cilën kompania synon të bëhet patron, është subjekt i një skandali korrupsioni.

Çfarë duhet të bëj?

Ju duhet ta vendosni transaksionin në pritje ndërsa vlerësoni ndershmërinë e fondacionit në dritën e këtij informacioni të ri të pafavorshëm, në konsultim me Pajtueshmërinë..





Klienti që punon në një sektor të ndjeshëm biznesi më kërkon të dërgoj një transfertë të etiketuar “donacion” në një fondacion që gjendet në një vend me rrezik korrupsioni dhe ku sapo ka fituar kontratë publike. Pas disa kërkimeve, zbuloj se ky fondacion është në pronësi të tërthortë të një personi të ekspozuar politikisht.

Çfarë duhet të bëj?

Ju duhet ta vendosni transaksionin në pritje ndërsa e vlerësoni ndershmërinë e fondacionit në dritën e informacionit të ri të pafavorshëm, në konsultim me Pajtueshmërinë.



Unë jam i shqetësuar: shtypi ka raportuar një skandal të paprecedentë që prek një klient, fondacioni i të cilit duket se ka mundësuar që pagesa t’u jenë bërë politikanëve për disa vite.

Çfarë duhet të bëj?

Informoni menaxherin tuaj të linjës dhe Pajtueshmërinë dhe aplikoni procedurat për rrezikun e vlerësimit për këtë marrëdhënie.

6

PËRFAQËSIMI I INTERESAVE (LOBIMI)

Përfaqësimi i interesave është aktiviteti i dhënies së informacionit për zyrtarët publikë, aty ku është e aplikueshme, për të ndikuar në vendimet e tyre. Ndikimi në vendimmarrjen publike mund të synojë në veçanti përmbajtjen e një ligji ose të një akti rregullator.

Përfaqësimi i interesave në emër të BNP Paribas mund të ushtrohet vetëm nga personat e autorizuar për ta bërë këtë me politikën e brendshme, të qasshme nga databaza e procedurave.



Unë kam një marrëdhënie të mirë me dikë që punon në një organ publik që ka rol vendimtar në hartimin e një projektligji duke prekur të gjithë profesionin. Është e qartë se ky tekst nuk u shërben interesave të askujt. Për fat të mirë, mendoj se mund të bind atë të ndryshojë dispozitat e ligjit në këmbim të një fundjave buzë detit.

A lejohet kjo?

Kjo situatë, e cilësuar si korrupsion, është e ndaluar nga BNP Paribas, pavarësisht interesave.

7

REKRUTIMI

Në asnjë rrethanë nuk mund të lejohet ose refuzohet rekrutimi në këmbim të një avantazhi të padrejtë, ose si kusht për të ushtruar ndikim.

Rekrutimi drejtohet nga procedurat e Burimeve Njerëzore të Grupit BNP Paribas, të qasshme nga databaza e procedurave, e cila duhet të zbatohet në të gjitha rrethanat.



Një konsulent i punësuar aktualisht për një detyrë mbështetëse gjashtëmujore më kërkon ta ndihmoj të marrë një pozitë me kohë të plotë brenda Grupit. Në këmbim, ai më premton të më japë një përqindje të pagës së tij të re. Çfarë duhet të bëj?

Refuzoni këtë kërkesë dhe informoni menaxherin tuaj të linjës dhe Pajtueshmërinë.



Një partner biznesi prej kohësh më premton se do të rrisë biznesin e tij nëse unë jam dakord për të siguruar një praktikë për djalin e tij, i cili sapo ka mbaruar studimet në një universitet prestigjioz.

Ju kontakton një politikan, i cili ju kërkon të rekrutoni nipin e tij.

Të dy do t'ju jenë shumë mirënjohës.

A mund t'i pranoj këto rekrutime?

Në këto dy ilustrime, ju duhet ta përcillni aplikacionin te Burimet Njerëzore, për të ndjekur procesin e zakonshëm të rekrutimit. Gjithashtu të informoni BNj-të për rrethanat dhe kërkesat rreth këtyre aplikacioneve, si dhe menaxherin tuaj të linjës dhe Pajtueshmërinë.



8

RREZIQET E NDËRLIDHURA ME KLIENTËT,
FURNIZUESIT DHE NDËRMJETËSIT

Klientët, furnizuesit dhe ndërmjetësit e Grupit BNP Paribas vlerësohen në lidhje me rreziqet e korrupsionit që ata mund të paraqesin. Ligjet dhe autoritetet kompetente kanë përcaktuar disa faktorë rreziku si të lartë: për shembull, llojet e caktuara të transaksioneve të tilla si bashkimet dhe blerjet, sektorë të caktuar të veprimtarisë ose vende, persona të ekspozuar politikisht etj.

Punonjësit nuk duhet të hyjnë në marrëdhënie afariste ose zotime kontraktuale, të ofrojnë ose japin çmime dhe komisione, ose një produkt apo shërbim Grupit BNP Paribas, në këmbim të një avantazhi të padrejtë ose si kusht për ushtrim ndikimi.

Po kështu, punonjësit duhet të përdorin shabllonet standarde të

kontratës së Bankës, janë në përputhje me procedurat e tenderit dhe përmbahen nga përdorimi i ofruesve të pamiruar të shërbimeve.

Prandaj, punonjësit duhet të sigurojnë se procedurat e vlerësimit dhe monitorimit të palëve të treta zbatohen në të gjitha fazat e marrëdhënies afariste, dhe të

sigurojnë që ata të ndjekin një politikë kundër korrupsionit që përputhet me detyrimet e Grupit BNP Paribas, duke rregulluar dokumentacionin kontraktual, kur aplikohet (klauzola kundër korrupsionit, klauzola të daljes, etj.).

KLIENTË

Punonjësit nuk duhet të hapin llogari, japin kredi ose financojnë, ose ndonjë produkt ose shërbim tjetër të Grupit BNP Paribas, për qëllim të përfitimit ose për të marrë një avantazh të padrejtë, qoftë për qëllime komerciale ose personale (shih politikat “Njih klientin tuaj”, të qasshme nga databaza e procedurave).



Një klient që takoj në klubin e tenisit më tregon për vështirësitë që një nga kompanitë e tij është duke i pasur marrjen e një kredie: të gjitha përpjekjet me banka kanë dështuar. Ai më pyeti se sa “do i kushtonte një ndihmë e vogël”.

Gjatë një ekspozite tregtare, mu afrua një person që dëshironte të hapte një llogari. Duke më parë që hezitaja, më ofron të veprojë nëpërmjet një personi të tretë, i cili do të më jepte një zarf si një faleminderit.

Çfarë duhet të them në këto dy raste?

Në të dyja këto ilustrime, ju duhet t’i refuzoni këto kërkesat të papranueshme që janë në kundërshtim me politikat e Grupit BNP Paribas, dhe deklarojini ato menaxherit tuaj të linjës dhe Pajtueshmërisë.





Këtë mëngjes, një nga klientët e mi më kërkoi të pranoja disa depozita të mëdha në para të gatshme, pa dhënë shpjegime se nga erdhën paratë. Nëse pranoj të mbyll sytë, klienti ka sugjeruar që ai të paguajë, në këmbim, një normë jashtëzakonisht të lartë të interesit në linjën e tij kreditore, e cila me të vërtetë do të më ndihmonte t'i arrija objektivat e mia të performancës.

Çfarë hapash duhet të ndërmarr?

Ju duhet të refuzoni transaksionin dhe të informoni menaxherin tuaj të linjës dhe Pajtueshmërinë.



Vura re se klienti im në sektorin e telekomunikacionit sapo ka hapur një filial të ri në një vend të ndjeshëm ndaj korrupsionit. Kohët e fundit, ky klient ka bërë një transfertë të madhe në emër të vajzës së Presidentit të atij vendi.

Shpjegimi i klientit për këtë transfertë të dyshimtë ishte e vështirë për t'u kuptuar.

Çfarë duhet të bëj?

Ju duhet ta raportoni këtë transaksion te menaxheri juaj i linjës dhe Pajtueshmëria.



E di që Plani Urbanistik Vendor është duke u rishikuar. Sidoqoftë, vërej pagesa të pazakonta në llogari të një klienti që është përfaqësues i zgjedhur lokal.

Çfarë duhet të bëj?

Ekziston dyshimi për ushtrim të ndikimit dhe ju duhet t'ia raportoni këto lëvizje menaxherit tuaj të linjës dhe Pajtueshmërisë.



Një klient që punon në një sektor të ndjeshëm shpall transfertën e një sasie të konsiderueshme në shlyerjen e bilancit të një kontrate të lidhur me një kompani që gjendet në një vend me rrezik korrupsioni. Unë e vërej se kjo kompani është subjekt i informacionit të pafavorshëm në lidhje me korrupsionin dhe se shuma e transferimit është shumë më e lartë se ajo e parashikuar në kontratë. Sipas klientit tim, diferenca është për shkak të "shpenzimeve të ndryshme".

A mund t'i zbatoj këto udhëzime?

Për të mos u përfshirë në marrëveshjen e një akti korrupsioni, pezulloni transaksionin, aplikoni procedurat për siguri financiare dhe informoni menaxherin tuaj të linjës dhe Pajtueshmërinë.





Pasi fitoi një kontratë të madhe jashtë vendit, klienti im më udhëzon të paguaj një shumë të madhe parash në llogarinë e një fondacioni të regjistruar në një parajsë tatimore, dhe që i përket ndërmjetësit që punon për palën tjetër të tij të sektorit publik.

Çfarë duhet të bëj?

Pezulloni këtë transaksion dhe zbatoni procedurat e vlerësimit. Informoni menaxherin tuaj të linjës dhe Pajtueshmërinë.



Pasi më informoi për vështirësitë në rrjedhën e tyre të parasë së gatshme, klienti ndaloi së shlyeri këstet e kredisë së tyre. Kur e kontaktoj atë, ai më ofron një “alternativë të thjeshtë”: jepini atij një heqje borxhi që i mundëson atij t’i shlyejë borxhet e tij, në këmbim të një ndarjeje “50-50”.

Çfarë duhet të bëj?

Ju nuk mund ta pranoni këtë propozim: një shlyerje me heqje borxhi, përfiton klienti debitor, nëse është i papërshtatshëm. Duhet ta raportoni këtë propozim te menaxheri juaj i linjës dhe Pajtueshmëria.



FURNIZUES

Integriteti i furnizuesve është një kusht thelbësor për marrëdhëniet e tyre me Grupin BNP Paribas. Punonjësit duhet të sigurojnë që reputacioni i Grupit të mbrohet nga çdo veprim që cenon integritetin e Grupit duke zbatuar procedurat e prokurimit të qasshme në databazën e procedurave.

Shih edhe më lart, kapitulli “Mbrojtja e Grupit” në Kodin e Grupit të Sjelljes, si dhe procedurën “Njih furnizuesin tënd” të qasshme nga databaza e procedurave.



Gjatë një thirrjeje për tender, një kompani ofertuese më kontakton: nëse pranoj ta ndihmoj të zgjidhet si furnizues i Grupit, kompania do të më paguajë 5% të shumës së faturave të saj në të ardhmen.

Unë përdor disa furnizues për mirëmbajtjen e ndërtesave. Më pas menjëherë, njëri prej tyre më ka dorëzuar biletat për një turne prestigjioz sportiv, që po zhvillohet shumë larg.

Çfarë duhet të bëj?

Në cilindo rast, ju duhet të refuzoni dhe menjëherë ta lajmëroni menaxherin tuaj të linjës dhe Pajtueshmërinë, si dhe Departamentin e Prokurimit, në mënyrë që integriteti i furnizuesit të mund të rivlerësohet.



NDËRMJETËS

Si çdo partner i Grupit BNP Paribas, ndërmjetësuesit u nënshtrohen vlerësimeve dhe kontrolleve (shih procedurën “Politika e Grupit për ndërmjetësit”, e qasshme nga databaza e procedurave).



Kohët e fundit, shitjet në një pjesë të portofolit tim kanë rënë. Unë kontaktova distributorin në fjalë për të kuptuar arsyet. Duket se distributori do të ishte më shumë i motivuar dhe do t'i jepte përparësi absolute shitjes së produkteve të mia, në këmbim të një kontributi duke e ndihmuar në organizimin e pushimeve të tij të ardhshme.

Si duhet t'i përgjigjem atij?

Ju duhet ta refuzoni me vendosmëri këtë kërkesë dhe të informoni menaxherin tuaj të linjës dhe Pajtueshmërinë në mënyrë që të rivlerësohet integriteti i këtij ndërmjetësi.



Një ofrues biznesi sugjeron që unë mund të rris me shpejtësi numrin e kredive për shtëpi falë një marrëveshje “win-win” (fito-fito): investitorët mund të kenë qasje lehtësisht në biznesin tim nëse mbyll sytë ndaj kushteve të përshtatshmërisë, dhe të paguajë pak më shumë për të plotësuar të ardhurat e tij.

Çfarë duhet të bëj?

Sido që të jenë çështjet e supozuara tregtare, është e ndaluar të jepet një përgjigje e favorshme për këtë formë të kërkesës. Informoni menaxherin tuaj të linjës dhe Pajtueshmërinë për t'i dhënë fund marrëdhënies me këtë ndërmjetës.



ILUSTRIMET E MËSIPERME TREGOJNË LARMINË E GJERË TË SITUATAVE NË CILAT GRUPI BNP PARIBAS MUND TË EKSPOZOHET NDAJ RREZIKUT TË KORRUPSIONIT OSE USHTRIMIT TË NDIKIMIT.

Nëse ka dyshime, pavarësisht nga situata e hasur, punonjësit duhet t'ia referojnë çështjen menaxherit të tyre të linjës ose Pajtueshmërisë.



BNP PARIBAS

**Bankë
për një botë
në lëvizje**